



RAPORTI VJETOR

2017

PËRMBAJTJA

HYRJE	4
II. REALIZIMI I TË ARDHURAVE	6
Grafik 1. Struktura e të ardhurave.....	11
Tabela 1. Totali DPT (12- mujori 2017).....	11
Tabela 2. Të ardhurat e realizuara për vitin 2017 sipas DRT-ve (000/lekë)	13
Tabela 3. Të ardhurat nga Tatimi mbi Vlerën e Shtuar (000/lekë)	14
Tabela 4. Të ardhura nga Tatimi mbi Fitimin 12-mujori (000/lekë)	14
Tabela 5. Të ardhurat nga Tatimi mbi të Ardhurat Personale (000/lekë)	15
Tabela 6. Krahassimi i TAP-it sipas zërave (000/lekë).....	15
Tabela 7. Të ardhura nga Taksat Kombëtare dhe Tarifa (000/lekë)	17
Tabela 8. Taksat Kombëtare dhe Tarifat sipas llojeve (përfshirë tarifa buxhetore).....	18
Tabela 9. Të ardhura nga Taksa e Qarkullimit dhe Karburantit (000/lekë).....	19
Tabela 10. Të ardhurat nga Sigurimet Shoqërore dhe Shëndetësore.....	19
III. SHËRBIMI I TATIMPAGUESVE	20
IV. KONTROLLI TATIMOR	27
Tabela 11. Realizimi i planit të numrit të kontrolleve për periudhën vitin 2017, sipas DRT-ve	29
V. MENAXHIMI I RISKUT	33
Tabela 12. Sektorët me Risk për të gjitha Drejtoritë Rajonale.....	33
Tabela 13. Pikët e riskut sipas sektorëve.....	35
VI. MBLEDHJA ME FORCË	38
Grafik 2. Struktura e borxhit tatimor	39
Grafik 3. Borxhi sipas llojit të Tatimit 2016 vs 2017.....	39
Grafik 4. Moshë e borxhit.....	40
Grafik 5. Borxhi sipas statusit të tatimpaguesit	40
Tabela 14: Pasqyra përmbledhëse e faljeve automatike dhe manuale.....	41
VII. PERFORMANCA TEKNIKO-LIGJORE	44
IX. TEKNOLOGJIA E INFORMACIONIT	46
X. RIMBURSIMI I TVSH-SË	48
Tabela 15. Situata e rimbursimit për kërkesat e mbartura nga viti 2016 deri në fund të vitit 2017	50
Tabela 16. Pëshja specifike e DRT në dhënien e rimbursimit për kërkesat e mbartura nga viti 2016 të rimbursuara nëpërmjet sistemit të thesarit brenda datës 31.12.2017	51

Tabela 17. Situata e kërkesave të paraqitura gjatë vitit 2017 sipas periudhës së depozitimit të kërkesës.....	52
Tabela 18. Situata e rimbursimit për kërkesat e vitit 2017 deri në fund të vitit 2017	52
Tabela 19. Pesha specifike që zë çdo DRT në dhënien e rimbursimit Cash për kërkesa të vitit 2017 të paguara nëpërmjet sistemit të thesarit brenda datës 31.12.2017	54
XI. MARRËDHËNIET DHE KOORDINIMI INSTITUCIONAL	57
XII. MENAXHIMI I PROJEKTEVE	59
XIII. QENDRA E PAGESAVE	60
XIV. HETIMI TATIMOR	61
XV. BURIMET NJERËZORE.....	65
XVI. BUXHETI DHE FINANCA.....	69
Tabela 20. Buxhetimi dhe shpenzimet	69
Grafik 6. Buxhetimi dhe shpenzimet	70

HYRJE

Raporti vjetor është një pasqyrë e veprimtarisë dhe rezultateve të administratës tatimore, gjatë vitit 2017, në raport me objektivat e Planit Strategjik 2017-2021 dhe planeve operacionale të vitit 2017.

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve është autoriteti shtetëror i specializuar, në varësi të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë për krijimin, sigurimin dhe mbledhjen e të ardhurave tatimore, si dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë.

Institucioni është i organizuar në nivel qendror me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, përgjegjëse për hartimin, monitorimin dhe zbatimin e strategjive dhe politikave operacionale, efikase në realizimin e misionit të institucionit. Në nivel rajonal, institucioni ka 14 Drejtori Rajonale Tatimore dhe në total në organikën e administratës tatimore shqiptare numërohen

1,569 punonjës duke e renditur administratën tatimore, si një nga institucionet ligjzbatuese më të rëndësishme në vend.

Mbledhja e të ardhurave tatimore dhe kontributeve shoqërore, synohet të realizohet nëpërmjet nxitjes së përmbushjes vullnetare dhe duke kërkuar nga të gjithë tatimpaguesit kuptimin dhe respektimin e detyrimeve ligjore.

Në këtë frymë, administrata tatimore nisur edhe nga praktikrat e shumë vende anëtare të BE-së që kanë ndryshuar qëndrimin e tyre ndaj taksapaguesve, duke u larguar nga monitorimi i njëanshëm i përmbushjes së detyrimeve tatimore, u orientua drejt një marrëdhënieje proaktive dhe partneriteti me tatimpaguesit, duke investuar në forcimin e besimit të tatimpaguesve në përmbushjen e nevojave të tyre. Përvoja tregon se tatimpaguesit e informuar kanë më shumë gjasë të përmbushin detyrimet e tyre në mënyrë të rregullt dhe kjo ka dhënë efekte të matshme e pozitive që do t'i gjeni në treguesit statistikorë në këtë raport.

Të dhënat e vitit 2017 tregojnë se angazhimi serioz në luftën kundër informalitetit ka dhënë efektet e pritura, që shërbejnë si indikator për rritjen e besimit dhe sigurimin e një mjedisi të shëndoshë ekonomik.

Objektivat strategjikë nga të cilat AT udhëhiqet janë:

- Garantimi i asistencës për përmbushjen vullnetare, përmes:
 - ofrimit të shërbimeve cilësore dhe reduktimit të barrës administrative në pagesën e detyrimeve tatimore dhe kontributeve shoqërore.
 - rritjes së ndërgjegjësimit publik duke ndihmuar në zhvillimin e kulturës për përmbushje vullnetare më të lartë dhe kuptimin e rolit të Administratës Tatimore në shoqëri.

- Zbatimi efikas i legjislacionit tatimor, sigurimeve shoqërore dhe hetimi i rasteve të mashtrimit tatimor, përmes:
 - zbatimit të strategjisë së përmbushjes së menaxhimit të riskut
 - përmirësimit të mëtejshëm të kontrollit tatimor dhe gjurmimit të mashtrimeve tatimore
 - mbledhjes efikase të borxhit
- Progresi organizativ i Administratës Tatimore dhe zhvillimi i kapaciteteve njerëzore, përmes:
 - aplikimit të metodave dhe sistemeve për të menaxhuar një administratë tatimore moderne
 - zhvillimit të kapaciteteve dhe motivimit të punonjësve
 - mbajtjes së proceseve optimale dhe strukturës së Administratës Tatimore
 - zhvillimit dhe përmirësimit të partneriteteve
 - modernizimit dhe rinovimit të infrastrukturës
 - ka një rritje cilësore të komunikimit me administratën tatimore, në raport me gjetjet e vitit 2016 (transparencën, komunikimin me biznesin, aksesin në kohë dhe cilësinë e informacionit),
 - Përmirësimit të komunikimit dhe shërbimet ndaj tatimpaguesve në periudhën 2016 – 2017
 - rritjes së cilësisë së shërbimeve elektronike të tatimeve që është dukshëm më e lartë në 2017, në të gjitha aspektet e vlerësuara, si : aksesit, besueshmëria dhe saktësia e përpunimit të të dhënave
 - rritjes së konsiderueshme në vlerësimin për cilësinë e raportit të auditimit, si dhe sjelljen e etikës së inspektorëve
 - rritjes së ndjeshme të ndërgjegjësimit të tatimpaguesve për Modulin e Analizës së Riskut dhe përzgjedhjen për inspektimet bazuar në të.

Raporti vjetor i Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve është një dokument publik i cili ngarkohet në faqen zyrtare të internetit www.tatime.gov.al



II. REALIZIMI I TË ARDHURAVE

Menaxhimi sipas objektivave

Gjatë periudhës janar - dhjetor 2017, një ndër objektivat kryesor të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve ishte:

- Ritja e pajtueshmërisë vullnetare
- Rritja e performancës së mbledhjes të të ardhurave tatimore mbi parashikimet aktuale;
- Përmirësimi dhe sigurimi i shërbimeve më të mira për tatimpaguesit;
- Reforma kundër informalitetit dhe fokusi në mirë-administrim;
- Trajnimi i vazhdueshëm për nënpunësit e të gjitha niveleve;

Për arritjen e objektivave u mbajt në konsideratë:

- përmirësimi i administrimit të mbledhjes së tatimeve me efekte rritjen e tyre
- efektet e paketës fiskale për vitin 2017

- forcimi i mbledhjes së taksave, bazuar në strategjinë e riskut të pajtueshmërisë
- përzgjedhja dhe trajnimi i stafit të administratës tatimore

2.1. Të ardhurat gjithsej

Administrata Tatimore Qendrore, për periudhën 12-mujore 2017, paraqet një performancë pozitive në mbledhjen e të ardhurave. Vendosmëria e administratës për të luftuar evazionin dhe ekonominë informale, si dhe fushatat sensibilizuese të ndërmarra kanë ndikuar në prirjen rritëse të të ardhurave.

Struktura e të ardhurave

Struktura e mbledhjes së të ardhurave përbëhet nga:

- Të ardhurat tatimore neto që përbëjnë **62 %** të të ardhurave totale
- Kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore që përbëjnë **38 %** të të ardhurave totale neto.

Të ardhurat e vitit 2017

Për vitin 2017, të ardhurat tatimore bruto gjithsej janë programuar 238.3 miliardë lekë dhe janë realizuar 228.6 miliardë lekë, me një mosrealizim në vlerë prej 9.8 miliardë lekësh ose 4.09% më pak.

Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2016, me realizim të ardhurash 210.8 miliardë lekë, rritja e të ardhurave tatimore është 17.7 miliardë lekë më shumë ose 8.41% më shumë.

Nga të dhënat statistikore të evidencës së realizimit të të ardhurave për këtë periudhë rezulton:

Të Ardhurat Tatimore

Për vitin 2017, të ardhurat tatimore janë programuar 158.3 miliardë lekë dhe janë realizuar 145.8 miliardë lekë, me një mosrealizim prej 12.5 miliardë lekë ose 7.91% më pak.

Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2016, në të cilën të ardhurat u realizuan 135.9 miliardë lekë, rezultatet janë në rritje me 9.9 miliardë lekë më shumë ose 7.26% më shumë.

Të Ardhurat nga Kontributet e Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetësore

Për vitin 2017, të ardhurat nga Kontributet e Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetësore janë programuar 80.1 miliardë lekë dhe janë realizuar 82.8 miliardë leke, me një rritje prej 2.8 miliardë lekë ose 3.46 % më shumë

Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2016, ku të ardhurat nga KSSHSH ishin 74.9 miliardë leke, rezultatet janë në rritje me 7.9 miliardë lekë më shumë ose 10.50 % më shumë

2.2. Të Ardhurat Tatimore ndarë sipas llojit

Realizimi i të ardhurave sipas llojit të tatimeve, krahasuar me planin e vitit 2017 dhe faktin e vitit 2016, për periudhën janar – dhjetor 2017, bazuar në të dhënat statistikore, paraqitet si më poshtë:

2.2.1. Tatimi mbi Vlerën e Shtuar

Për 12 mujorin 2017, të ardhurat tatimore nga Tatimi mbi Vlerën e Shtuar (neto) ishin programuar në vlerën prej 38.7 miliardë lekë dhe janë realizuar në vlerën prej 35.1 miliardë lekë, më një mosrealizim në vlerë prej 3.6 miliardë lekë ose 9.36% më pak.

Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2016, në të cilën u arkëtuan 33.9 miliardë lekë, të ardhurat nga TVSH-ja neto janë arkëtuar 1.2 miliardë lekë më tepër ose 3.40 % më shumë.

2.2.2. Rimbursimi i TVSH-së

Për 12 mujorin 2017 rimbursimi për TVSH-në ishte programuar 16.6 miliardë lekë dhe është realizuar në vlerën 13.9 miliardë lekë me një mosrealizim prej 2.7 milion ose 16.44% më pak.

Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2016 në të cilën janë rimbursuar 8.8 miliardë lekë, rimbursimet janë realizuar 4.9 miliardë lekë ose 56.12% më shumë.

2.2.3. Tatimi mbi Fitimin

Të ardhurat tatimore nga Tatimi mbi Fitimin, janë programuar 29.2 miliardë lekë dhe aktualisht janë arkëtuar 31.6 miliardë lekë, me një mbirealizim prej 2.4 miliardë lekë ose 8.22 % më shumë.

Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2016, në të cilën u arkëtuan 29.2 miliardë lekë, të ardhurat nga ky lloj tatimi janë realizuar 2.4 miliardë lekë më tepër ose 8.05% më shumë.

2.2.4. Tatimi mbi të Ardhurat Personale

Tatimi mbi të ardhurat personale është programuar 36.2 miliardë lekë dhe është realizuar 32.1 miliardë lekë, me një mosrealizim prej 4.1 miliardë lekë ose 11.20% më pak.

Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, në të cilin u arkëtuan 31.5 miliardë lekë, të ardhurat nga ky lloj tatimi janë realizuar 643 milion lekë më tepër ose 2.04 % më shumë.

2.2.5. Taksat Kombëtare dhe Tarifa

Të ardhurat tatimore nga Taksat dhe Tarifa Kombëtare janë programuar në vlerën 13.3 miliardë lekë dhe faktikisht janë arkëtuar 12.4 miliardë lekë, me një mosrelizim 882 milion lekë ose 6.63% më pak.

Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2016, në të cilën u arkëtuan 10.9 miliardë leke, mbledhja e taksave është realizuar me një rritje prej 1.4 miliardë lekë ose 12.96% më shumë.

2.2.6. Taksa e Qarkullimit dhe Karburantit

Te ardhurat tatimore nga Taksat e Qarkullimit dhe Karburantit, të cilat janë programuar 19.3 miliardë lekë, janë arkëtuar 15.2 miliardë lekë, me një mosrealizim në vlerë prej 4.1 miliardë lekë ose 21.47% me pak.

Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2016, në të cilën u arkëtuan 16.4 miliardë lekë, të ardhurat janë realizuar me rënie prej 1.3 miliardë lekë ose 7.62% më pak.

Kjo taksë mbledhet nga agjentë, kryesisht Doganat.

Struktura e të Ardhurave Tatimore për periudhën 12-mujore 2017

Struktura e të ardhurave tatimore tregon se:

- TVSH-ja vazhdon të jetë kontribuesi kryesor në të hyrat publike me 34% të të ardhurave tatimore.

- Tatimi mbi të ardhurat personale përbën 22 % të të ardhurave tatimore,
- Tatimi mbi fitimin zë 22 % të të ardhurave tatimore,
- Taksa e qarkullimit dhe karburantit me 10% të të ardhurave tatimore.

Grafik 1. Struktura e të ardhurave




Tabela 1. Totali DPT (12- muji 2017)

E M E R T I M I		FAKTET		PLANI	Diferenca Fakt Plan		Diferenca 2017- 2016	
		2016	2017	2017	+ ose -	Përqindje	+ ose -	Përqindje
	D.P.TATIMEVE TOTAL (Bruto)	210,836,881	228,577,581	238,335,000	(9,757,419)	-4.09%	17,740,700	8.41%
A	Të Ardhurat Tatimore gjithsej (arkëtim)	135,891,943	145,760,105	158,285,000	(12,524,895)	-7.91%	9,868,162	7.26%
1	TVSH (bruto)	42,795,325	48,935,239	55,285,000	(6,349,761)	-11.49%	6,139,914	14.35%
	- TVSH (neto)	33,909,509	35,062,966	38,683,000	(3,620,034)	--9.36%	1,153,457	3.40%
	- Rimbursimi i kryer	8,885,816	13,872,274	16,602,000	(2,729,726)	-16.44%	4,986,461	56.12%
2	Tatim mbi Fitimin	29,245,999	31,599,398	29,200,000	2,399,398	8.22%	2,353,399	8.05%
3	Ardhura Personale	31,501,379	32,144,054	36,200,000	(4,055,946)	-11.20%	642,675	2.04%
4	Taksat Nacionale	10,993,777	12,418,438	13,300,000	(881,562)	-6.63%	1,424,661	12.96%
5	Taksa Qarkullimit dhe Karburantit	16,406,238	15,155,586	19,300,000	(4,144,414)	-21.47%	(1,250,652)	-7.62%
6	Lojrat e Fatit	4,767,174	5,349,807	5,000,000	349,807	7.00%	582,633	12.22%

7	Të tjera pa identifikuar	15,352	0	0	0	#DIV/0!	(15,352)	-100.00%
8	Dënimet Administrative	166,699	157,582	0	157,582	#DIV/0!	(9,117)	-5.47%
B	Të Ardhurat Tatimore (neto)	127,006,127	131,887,831	141,683,000	(9,795,169)	-6.91%	4,881,703	3.84%
C	Kontributet e Sigurimeve	74,944,938	82,817,476	80,050,000	2,767,476	3.46%	7,872,538	10.50%
D	D.P.TATIMEVE TOTAL (Neto)	201,951,065	214,705,307	221,733,000	(7,027,693)	-3.17%	12,754,240	6.32%

Tabela 2. Të ardhurat e realizuara për vitin 2017 sipas DRT-ve (000/lekë)

	Të ardhura total			Të ardhura neto			Sigurime Shoqërore		
	Fakt	Plan	%	Fakt	Plan	%	Fakt	Plan	%
Berat	3,349,009	3,506,000	-4.48%	825,868	962,000	-14.15%	2,150,736	2,109,000	1.98%
Dibër	3,185,688	2,889,000	10.27%	1,298,781	1,081,000	20.15%	1,789,622	1,713,000	4.47%
Durrës	12,637,135	12,460,000	1.42%	4,169,896	4,008,000	4.04%	7,246,536	6,952,000	4.24%
Elbasan	6,158,086	6,003,000	2.58%	1,565,255	2,074,000	-24.53%	3,785,849	3,684,000	2.76%
Fier	7,221,349	7,836,000	-7.84%	1,812,873	2,648,000	-31.54%	4,351,929	4,168,000	4.41%
Gjirokastrë	2,478,656	2,489,000	-0.42%	835,334	836,000	-0.08%	1,565,845	1,553,000	0.83%
Korçë	5,144,981	5,160,000	-0.29%	1,699,584	1,730,000	-1.76%	3,208,970	3,230,000	-0.65%
Kukës	1,840,929	1,674,000	9.97%	624,627	488,000	28.00%	1,177,060	1,131,000	4.07%
Lezhë	3,252,721	3,085,000	5.44%	1,131,470	1,019,000	11.04%	2,045,737	1,981,000	3.27%
Sarandë	1,580,661	1,490,000	6.08%	601,201	636,000	-5.47%	945,407	845,000	11.88%
Shkodër	5,350,411	5,291,000	1.12%	1,494,064	1,366,000	9.38%	3,528,498	3,500,000	0.81%
Tiranë	83,153,575	86,518,000	-3.89%	50,590,993	55,228,000	-8.40%	29,863,561	27,515,000	8.54%
DTM	88,524,241	95,234,000	-7.05%	63,403,337	67,772,000	-6.45%	18,461,634	18,992,000	-2.79%
Vlorë	4,700,141	4,700,000	0.00%	1,834,548	1,835,000	-0.02%	2,696,091	2,677,000	0.71%
Total	228,577,581	238,335,000	-4.09%	131,887,831	141,683,000	-6.91%	82,817,476	80,050,000	3.46%

Tabela 3. Të ardhurat nga Tatimi mbi Vlerën e Shtuar (000/lekë)

	Fakti TVSH		Plan TVSH		Ndryshimi %	
	neto	bruto	neto	bruto	neto	bruto
Berat	141,836	514,241	280,000	715,000	-49.34%	-28.08%
Dibër	358,723	456,008	248,000	343,000	44.65%	32.95%
Durrës	920,994	2,141,697	955,000	2,455,000	-3.56%	-12.76%
Elbasan	65,015	871,997	810,000	1,055,000	-91.97%	-17.35%
Fier	261,624	1,318,171	1,045,000	2,065,000	-74.96%	-36.17%
Gjirokastrë	264,887	342,364	310,000	410,000	-14.55%	-16.50%
Korçë	523,829	760,256	555,000	755,000	-5.62%	0.70%
Kukës	236,285	275,527	159,000	214,000	48.61%	28.75%
Lezhë	501,388	576,902	431,000	516,000	16.33%	11.80%
Sarandë	260,262	294,315	275,000	284,000	-5.36%	3.63%
Shkodër	340,873	668,722	295,000	720,000	15.55%	-7.12%
Tiranë	11,423,906	14,122,922	11,440,000	15,215,000	-0.14%	-7.18%
DTM	19,242,825	25,902,095	21,340,000	29,810,000	-9.83%	-13.11%
Vlorë	520,519	690,021	540,000	728,000	-3.61%	-5.22%
Totali	35,062,966	48,935,239	38,683,000	55,285,000	-9.36%	-11.49%

Tabela 4. Të ardhura nga Tatimi mbi Fitimin 12-mujori (000/lekë)

Tatimi mbi fitimin			
	Fakt	Plan	%
Berat	271,237	266,000	1.97%
Dibër	479,526	359,000	33.57%
Durrës	1,638,267	1,310,000	25.06%
Elbasan	648,554	431,000	50.48%
Fier	800,646	791,000	1.22%
Gjirokastrë	196,576	166,000	18.42%
Korçë	434,810	378,000	15.03%
Kukës	165,725	103,000	60.90%
Lezhë	259,021	215,000	20.47%
Sarandë	134,803	135,000	-0.15%
Shkodër	406,955	364,000	11.80%
Tiranë	7,548,803	6,313,000	19.58%
DTM	18,113,254	17,864,000	1.40%
Vlorë	501,222	505,000	-0.75%
Totali	31,599,398	29,200,000	8.22%

Tabela 5. Të ardhurat nga Tatimi mbi të Ardhurat Personale (000/lekë)

	Fakt	Plan	%
Berat	342,309	347,000	-1.35%
Diber	340,733	352,000	-3.20%
Durres	1,467,984	1,542,000	-4.80%
Elbasan	707,403	699,000	1.20%
Fier	661,927	743,000	-10.91%
Gjirokaster	303,044	277,000	9.40%
Korce	628,358	671,000	-6.36%
Kukes	197,380	207,000	-4.65%
Lezhe	340,035	347,000	-2.01%
Sarande	186,226	206,000	-9.60%
Shkoder	694,449	665,000	4.43%
Tirane	11,629,786	12,715,000	-8.53%
DTM	14,016,264	16,816,000	-16.65%
Vlore	628,156	613,000	2.47%
Totali	32,144,054	36,200,000	-11.20%

Tabela 6. Krahësimi i TAP-it sipas zërave (000/lekë)

		FAKT	PLANI	Diferenca PLAN - FAKT	
		2017	2017	+ ose -	Përqindje
	Tatimi mbi të ardhurat personale	32,144,054	36,200,000	(4,055,946)	-11.2%
1	Tatimi mbi pagë nga listë-pagesa	19,360,599	19,300,000	60,599	0.31%
1,1	Nga të punësuarit e sektorit Publik	7,115,021	6,500,000	615,021	9.5%
1,2	Nga të punësuarit e sektorit Privat	12,245,579	12,800,000	(554,421)	-4.3%
2	Tatim mbi të Ardhurat nga Interesat	2,108,807	3,400,000	(1,291,193)	-38.0%
3	Tatim mbi të Ardhurat nga Qiratë	3,760,031	4,250,000	(489,969)	-11.5%
4	Tatim mbi Fituesit e Lodrave të Fatit	81,295	50,000	31,295	62.6%
5	Tatim mbi A.Personale Biznesi Vogël me xhiro 2-8 mln lekë	9,652	10,000	(348)	-3.5%
6	Të tjera Tatime mbi të Ardhurat Burim	3,276,664	5,600,000	(2,323,336)	-41.5%
7	Tatimi mbi të ardhurat nga Dividentët dhe Aksionet	3,035,473	3,000,000	35,473	1.2%
8	Tatim mbi të Drejtën e Autorit dhe Pronësisë Intelektuale	305,411	300,000	5,411	1.8%

9	Tatimi mbi Deklaratën Individuale Vjetore të të ardhurave	206,122	290,000	(83,878)	-28.9%
----------	--	---------	---------	----------	--------

Tabela 7. Të ardhura nga Taksat Kombëtare dhe Tarifa (000/lekë)

	Fakt	Plan	%
Berat	67,357	69,000	-2.38%
Dibër	105,531	97,000	8.79%
Durrës	124,097	201,000	-
Elbasan	92,571	94,000	-1.52%
Fier	75,738	69,000	9.76%
Gjirokastrë	65,418	83,000	-
Korçë	104,576	126,000	-
Kukës	24,388	19,000	28.36%
Lezhë	26,722	26,000	2.78%
Sarandë	10,991	20,000	-
Shkodër	43,508	42,000	3.59%
Tiranë	4,258,304	4,919,000	-
DTM	7,328,593	7,453,000	-1.67%
Vlorë	90,644	82,000	10.54%
Totali	12,418,438	13,300,000	-6.63%

Tabela 8. Taksat Kombëtare dhe Tarifat sipas llojeve (përfshirë tarifa buxhetore)

Struk.	Lloji i të Ardhurave	FAKTET		PLANI	Diferenca Plan-Fakt	
		2016	2017	2017	+ ose -	Perqindje
A	TAKSAT dhe TARIFA NACIONALE	10,993,775	12,418,438	13,300,000	(881,562)	-6.6%
B	Tarifa Kombëtare	1,989,891	1,741,731	2,629,000	(887,269)	-33.7%
C	Taksa Kombëtare	9,003,885	10,676,707	10,671,000	5,707	0.1%
	<i>Tarifa "BUXHETORE"</i>	3,746,872	3,820,150	3,790,000	30,150	0.8%
1	Tarifë shërbimi për Qarkullimin e Automjeteve të Huaja	140,024	97,106	160,000	(62,894)	-39.3%
2	Tarifë për regjistrimin e Lojrave të Fatit , Llotarive , Kazinove etj	27,848	34,957	40,000	(5,043)	-12.6%
3	Tarifë shërbimi për licencat radiotelevizive	20,227	21,348	25,000	(3,652)	-14.6%
4	Tarifë shërbimi për përdorimin e aparateve televizive	1,346,170	1,188,660	1,440,000	(251,340)	-17.5%
5	Tarifë shërbimi për shërbimet e radiokomunikacionit	409,597	492,431	409,000	83,431	20.4%
6	Taksë kombëtare për lejen e ushtrimit të veprimtarisë së peshkimit	16,220	20,043	25,000	(4,957)	-19.8%
7	Taksë kombëtare e karbonit për benzinen, benzolin dhe gazoilin	2,191,006	2,095,154	2,600,000	(504,846)	-19.4%
8	Taksë kombëtare për ambalazhet plastike të lëngjeve të ambalazuara (shishe, bidona etj)	1,697,619	1,760,099	2,000,000	(239,901)	-12.0%
9	Taksë mbi të drejtën e përdorimit të truallit shtetëror nga persona juridik, tregtarë dhe ndërmarrje shtetërore	26,665	45,023	35,000	10,023	28.6%
10	Taksë mbi Primet e Shkruara Bruto	0	337,897	0	337,897	0.0%
11	Taksë për regjistrim fillestar për automjetet luksoze	0	42,613	0	42,613	0.0%
12	Taksë e përvitshme për automjetet luksoze	0	99,612	50,000	49,612	99.2%
13	Taksë për automjetet e përdorura të transportit	4,063,487	4,244,722	4,800,000	(555,278)	-11.6%
14	Tarifë shërbimi për kalimin e kufirit me avion	1,337,523	1,585,749	1,337,000	248,749	18.6%
15	Taksa portuale	720	846	1,000	(154)	-15.4%
16	Taksa e Akteve dhe e Pullës	275,588	254,995	340,000	(85,005)	-25.0%
17	Taksa e rentës minerare	728,480	1,568,171	820,000	748,171	91.2%
18	Tarifë për Shërbimet Konsullore	402,074	292,920	352,000	(59,080)	-16.8%
19	Tarifë për paisjen me Dëshmi Aftësie për drejtim automjeti	251,507	260,391	252,000	8,391	3.3%
20	Tarifë për regjitrin në Arsimin e Lartë	1,079,850	943,024	1,504,000	(560,976)	-37.3%
21	Tarifë për pasaportë lundrimin e personave	2,041	1,972	0	1,972	0.0%
22	Tarifa për aktet administrative	713,667	639,604	900,000	(260,396)	-28.9%
23	Tarifa , gjoba, interesa	6,233	3,720	0	3,720	0.0%
24	Taksa të tjera , gjoba, interesa	4,101	207,531	0	207,531	0.0%
A+C	Gjithesëj (Taksa , tarifa nacionale + tarifa buxhetore)	14,740,647	16,238,589	17,090,000	(851,411)	-5.0%


Tabela 9. Të ardhura nga Taksa e Qarkullimit dhe Karburantit (000/lekë)

	Fakt	Plan	%
Berat	0	0	0.00%
Dibër	0	0	0.00%
Durrës	0	0	0.00%
Elbasan	0	0	0.00%
Fier	0	0	0.00%
Gjirokastër	0	0	0.00%
Korçë	0	0	0.00%
Kukës	0	0	0.00%
Lezhë	0	0	0.00%
Sarandë	0	0	0.00%
Shkodër	0	0	0.00%
Tiranë	15,155,445	19,260,000	-21.31%
DTM	141	40,000	-99.65%
Vlorë	0	0	0.00%
Totali	15,155,586	19,300,000	-21.47%

Tabela 10. Të ardhurat nga Sigurimet Shoqërore dhe Shëndetësore

	Fakt	Plan	%
Berat	2,150,736	2,109,000	1.98%
Dibër	1,789,622	1,713,000	4.47%
Durrës	7,246,536	6,952,000	4.24%
Elbasan	3,785,849	3,684,000	2.76%
Fier	4,351,929	4,168,000	4.41%
Gjirokastër	1,565,845	1,553,000	0.83%
Korçë	3,208,970	3,230,000	-0.65%
Kukës	1,177,060	1,131,000	4.07%
Lezhë	2,045,737	1,981,000	3.27%
Sarandë	945,407	845,000	11.88%
Shkodër	3,528,498	3,500,000	0.81%
Tiranë	29,863,561	27,515,000	8.54%
DTM	18,461,634	18,992,000	-2.79%
Vlorë	2,696,091	2,677,000	0.71%
Totali	82,817,476	80,050,000	3.46%

III. SHËRBIMI I TATIMPAGUESVE



Forcimi i shërbimit të tatimpaguesve duke inkurajuar deklarin dhe përmbushjen vullnetare të detyrimeve të biznesit.

Puna e Drejtorisë së Shërbimit për Tatimpaguesit në DPT, është përqendruar në realizimin e detyrave dhe objektivave të përcaktuara në Planin Operacional të vitit 2017, që janë:

Objektivi 1 - Garantimi i asistencës për përmbushjen vullnetare

Objektivi 2 – Zbatimi efikas i legjislacionit tatimor dhe sigurimeve shoqërore, dhe hetimi i rasteve të mashtrimit tatimor si dhe detyrave të ngarkuara në funksion të reformave të DPT-së.

1. Regjistrimi dhe azhurnimi i Regjistrit Kombëtar të tatimpaguesve

Numri i tatimpaguesve aktivë, (që kanë të paktën një përgjegjësi tatimore) në Regjistrin Kombëtar në fund të vitit 2017 rezulton: **148,056** tatimpagues gjithsej nga të cilët 36,646 fermerë. Nga shifra gjithsej e aktivëve janë të regjistruar në përgjegjësinë tatimore TVSH 37,616 tatimpagues, nga të cilët 16,998 janë tatimpagues të biznesit të vogël.

Gjatë 12-mujorit 2017, sipas të dhënave të transmetuara nga QKB dhe atyre të ngarkuara në sistem, nga veprimet e kryera nga DRT-të në rrethe, për tatimpaguesit që regjistrohen nga ana e tyre, rezultojnë se:

- Janë regjistruar si tatimpagues të rinj dhe të hedhur në Regjistrin Kombëtar 19,956 tatimpagues nga të cilët 18,720 tatimpagues si biznes i vogël, 1,108 tatimpagues si biznes i madh dhe 128 (OjF, ambulantë etj).
- Gjatë këtij viti janë regjistruar nga DRT edhe 5,508 fermerë, në zbatim të ligjit të TVSH-së.
- Gjate vitit 2017 janë regjistruar nën përgjegjësinë tatimore TVSH-se 7,753 tatimpagues (nga regjistrimet e reja ardhur nga QKB dhe nga ndryshimet e përgjegjëseve gjatë vitit nga ana e DRT-ve).

Realizimi i funksionit të regjistrimit të subjekteve të reja nga sektori i asistencës dhe regjistrimit në DPT dhe nga DRT, është bërë nëpërmjet:

- bashkëpunimit me QKB-në për regjistrimin e bizneseve të reja
- mbikqyrjes së regjistrimit të tatimpaguesve të kategorive OJF, ambulantë, fermerë etj., në Drejtoritë Rajonale.

2. Kalimi në pasiv i tatimpaguesve

Kalimi në pasiv i tatimpaguesve, për vitin 2017, ka qenë një proces që është kryer pothuajse në mënyrë automatike, në sistemin informatik të DPT, por dhe DRT-të në rrethe. Nga të dhënat që administrojmë, në fund të vitit 2017, 12,886 tatimpagues kanë kaluar pasiv.

Theksojmë se procedurat e kalimit në pasiv tashmë janë më të qarta dhe më të thjeshta.

3. Shërbim dhe asistencë cilësore për tatimpaguesit

Tatimpaguesve, u është ofruar shërbim cilësor dhe profesional për kërkesat, që ata kanë paraqitur në bazë të vizitave, telefonatave, e-maile-ve apo kërkesave të dërguara në formë shkresore. Gjatë

periudhës janar – dhjetor 2017, është punuar në drejtim të përmirësimit dhe rritjes së nivelit të shërbimit që iu ofrohet tatimpaguesve. Në zyrat e Shërbimit të Tatimpaguesve u është ofruar asistencë dhe shërbim për pyetjet, kërkesat apo informacione, që kanë kërkuar në lidhje me plotësimin e detyrimeve tatimore, ndryshimet e legjislacionit tatimor, pajisjen me vërtetime etj.. Më shumë se 367,000 tatimpagues janë asistuar “ballë për ballë” në sportelet pritëse. Numri i vërtetimeve të lëshuara në sportele për vitin 2017 është 244.795, shifër 22% më e ulët, krahasuar me vitin 2016, kur ishin 04.350 vërtetime të lëshuara. Kjo ulje e numrit të kërkesave për vërtetime në sportele, ka ardhur si rezultat i ofrimit që prej muajit tetor 2017 i 9 shërbimeve të DPT (9 vërtetimeve merren nëpërmjet portalit qeveritar e-Albania). *Ky portal u ofron tashmë mundësi, subjekteve tatimpagues dhe individëve të interesuar që 9 lloje vërtetimesh t'i marrin automatikisht, në mënyrë elektronike, me vulë dixhitale, pa pasur detyrimin të paraqiten në zyrat e Shërbimit, duke kursyer në këtë mënyrë kohë dhe burime njerëzore.*

Shërbimet e DPT që ofrohen online nëpërmjet e-Albania janë:

1. Vërtetim për posedim mjeti
2. Vërtetim për pagimin e detyrimeve tatimore
3. Vërtetim për Kontributet e paguara (për subjekt)
4. Vërtetim për xhiron e 3 viteve të fundit (për tender)
5. Vërtetim për Përgjegjësitë Tatimore
6. Vërtetim statusi (aktiv, pasiv)
7. Vërtetim për Kontributet e paguara (për individë)
8. Vërtetim për regjistrim të investitorit
9. Vërtetim për individët të paregjistruar

Informimi dhe edukimi tatimpaguesve

Tatimpaguesit e rinj, janë informuar nëpërmjet dërgimit të një njoftimi me postë ose me vizita të drejtëpërdrejta në Qendrat e Shërbimit apo sportelet e Shërbimit për tatimpaguesit. Në shumicën e Drejtorive Rajonale, është caktuar një ditë në javë për trajnimin e tatimpaguesve të rinj. Trajnimi si proces zhvillohet çdo ditë edhe individualisht, për t'i njohur tatimpaguesit me përgjegjësitë e tyre tatimore, proceset e deklarimit elektronik, afatet e deklarimit, etj.

Për herë të parë, gjatë vitit 2017, u ideua dhe u vu në zbatim kryerja e Vizitave informuese në terren në të gjithë territorin, ku punonjës të Shërbimit për Tatimpaguesit kryenin vizita në mjediset e ushtrimit të aktivitetit të tatimpaguesve, me qëllim informimin dhe sensibilizimin e tyre për plotësimin e detyrimeve tatimore. Gjatë periudhës Tetor - Dhjetor 2017, janë zhvilluar 132 takime me komunitetin e biznesit (tryeza diskutimi) dhe 13.956 vizita informuese.



Tabela 11: Përshkrimi i kontakteve dhe shërbimeve të ofruara gjatë vitit 2017

Numri i njoftimeve të dërguar tatimpaguesve me qëllim parandalimin e mashtrimit dhe nxitjen e korrektimit vullnetar.	205.691
Numri i takimeve të mbajtura me tatimpaguesit me qëllim parandalimin e mashtrimit dhe nxitjen e korrektimit vullnetar.	7.070
Numri total i vizitave këshilluese të përfunduara	67.014
Numri i seminareve edukues të realizuar	89
Numri total i taksapaguesve të asistuar (ballë për ballë)	367.132

Informimi i tatimpaguesve për ndryshimet ligjore

Në mënyrë periodike është realizuar përditësimi në kohë reale i çdo materiali në faqen zyrtare të internetit (Legjislacioni, kalendari, njoftime për tatimpaguesit etj). Gjithahstu, janë publikuar të gjitha ndryshimet e Legjislacionit tatimor në fuqi, të shoqëruara edhe me njoftimet perkatese, më shumë se 90 të tilla, si dhe materiale informuese për tatimpaguesit.

Përveçse nëpërmjet faqes së internetit dhe njoftimeve të publikuar anë të, tatimpaguesit janë njohur dhe njoftuar në lidhje me ndryshimet e legjislacionit tatimor, edhe nëpërmjet njoftimeve të dërguara në llogaritë e tyre të e-Filing, njoftimeve të vendosura në stendat e Qendrave të Shërbimit apo Zyrave të shërbimit për tatimpaguesit.

Rëndësi e veçantë iu kushtua informimit të tatimpaguesve në lidhje me: Ligjin e Faljes/Shuarjes së detyrimeve tatimore, (etapat e zbatimit të këtij Ligji si dhe përfituesit pas çdo etape), fazën e dytë të Aksionit të luftës kundër informalitetit, etj.

Gjatë vitit 2017 u përditësuan dhe u prodhuan materialet për një set prej 14 fletëpalosje informuese dhe disa postera: Qendra e Thirrjeve, Të drejtat e tatimpaguesve, si dhe Karta e Tatimpaguesit.

Shërbimi ndaj tatimpaguesit dhe bashkëpunimi me institucione të tjera

- Me qëllim shtrirjen e ofrimit të shërbimeve si dhe lehtësimin e kostove administrative për tatimpaguesit, në bashkëpunim me ADISA-n gjatë vitit 2017 e në vijim, DPT është prezente me shërbimet e saj edhe në qendrat ONE-STOP-SHOP të ADISA-s në Krujë, Kavajë, Fier dhe Gjirokastrë.
- Gjithashtu në bazë të një marrëveshjeje me QKB, në zyrat qendrore në Tiranë, tashmë ka një sportel të DPT, të dedikuar për tatimpaguesit e rinj.

4. Qendra e Thirrjeve



Gjatë vitit 2017 një shërbim i ri tatimpaguesve, Qendra e Thirrjeve. Kjo qendër ka si objektiv kryesor **garantimim e komunikimit me tatimpaguesit për përmbushjen vullnetare.**

- Gjatë vitit 2017 janë realizuar 9,534 thirrje hyrese, 49,342 thirrje dalëse dhe 5,394 komunikime nëpërmjet live chat.
- Janë realizuar 23 fushata sipas tematikës së mëposhtme:
 - 10 fushata për motransmetues të pajisjeve fiskale.
 - 2 fushata për tatimpagues debitor të TVSH-se.
 - 1 fushate për Turizmin.
 - 2 fushata për tatimpagues mosdeklarues të TVSH-se.
 - 1 fushatë për destinimin e fitimit neto.
 - 1 fushatë për tatimpaguesit që nuk kishin paguar këstet e tatim fitimit.
 - 1 fushatë për tatimpagues debitor.
 - 3 fushata për tatimpagues debitor në Kontributet e Sigurimeve.
 - 1 fushatë për pajisjen dhe përdorimin e pajisjeve fiskale.
 - 1 fushatë për tatimpagues pasiv që kishin kryer blerje
- Në bashkëpunim me Drejtorinë e Borxhit janë telefonuar 5,130 tatimpagues debitor me qëllim nxitjen , përmbushjen dhe arkëtimin e detyrimeve të prapambetura.
- Trajnim i stafit me ekspertët e FSVK-së për praktikat më të mira ndërkombëtare.

IV. KONTROLLI TATIMOR

Gjatë vitit 2017, Drejtoria e Kontrollit Tatimor në DPT, bazuar në objektivat Strategjike të hartuara dhe miratuar, punoi dhe realizoi detyrat e ngarkuara në funksion të rritjes së performacës së administratës tatimore për mbledhjen dhe realizimin e të ardhurave buxhetore.

Realizimet e Drejtorisë së Kontrollit Tatimor, bazuar në Rregulloren e Brendshme të Administratës Tatimore, në kërkesat e Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në RSH”, i ndryshuar dhe Udhëzimit të Ministrit të Financave në zbatim të tij, si dhe në zbatim të objektivave të Planit Strategjik 2017-2021, kanë konsistuar në drejtimet e mëposhtme:

1. Në përmiresimin dhe rritjen e kontaktit me anë të adresës elektronike apo takime me tatimpaguesin për stimulimin për ndryshime vullnetare të deklaratave. Plotësim në kohë dhe me lehtësi të deklaratave dhe formularëve. Lehtësimi i procedurave dhe kërkesave administrative për tatimpaguesit e Administratës Tatimore, duke marrë në konsideratë ndër të tjera madhësinë e tyre si dhe thjeshtëzimin e deklaratave dhe formularëve, evidentimi i problematikave dhe nxjerrja e rezultateve. Lehtësimi i procesit për tatimpagues të cilët bëjnë gabime jo në mënyrë të qëllimshme. Lidhur me realizimin dhe rezultatat e punës sipas këtij objekti, referuar rekomandimeve të FMN-së u realizua analiza e 6 sektorëve që paraqesin më shumë risk, në Dhjetor të vitit 2016. Mbi bazën e kësaj analize u iniciuan plane sektoriale, ai i Shëndetësisë dhe i Tregëtisë. Këto plane arritën qëllimin e administratës tatimore për rritjen e bashkëpunimit dhe forcimin e lidhjeve me tatimpaguesin, për njoftime të vazhdueshme për stimulimin e përmbushjes vullnetare të deklarimit të të ardhurave tatimore. Në këtë kuadër u kryen analiza dhe u bë perzgjedhja e subjekteve me risk nga DMR. Mbi bazën e këtij risku Drejtoria e Kontrollit në DPT hartoi planin për çdo DRT-ë në lidhje me këto dy sektorë.
2. Në bazë të objektivit strategjik gjatë vitit 2017, Administrata Tatimore ka synuar që bazuar në planin e kontroleve të evidentohen pyetjet kryesore, të cilat do të shërbejnë për përditësim të vazhdueshëm të infomaciaonit në faqen e Administratës Tatimore në menyrë që të kemi një pasqyrim të saktë të deklarimeve dhe pagesave. Lidhur me këtë administrata tatimore nga

pyetsorët ka grumbulluar dhe evidentuar informacionin e nevojshëm për tatimpaguesit të cilat janë publikuar në faqen e internetit të Administratës Tatimore si më poshtë:

- Njoftim për zbatimin e procedurave të dorëzimit elektronik të pasqyrave financiare të vitit 2016.
- Njoftim për zbatimin e procedurave të dorëzimit elektronik për paqyrat financiare të vitit 2016 nga OJF.
- Njoftim për deklarata dhe afatet e Deklaratës Individuale Vjetore të të Ardhurave për vitin 2016.
- Informacion për individët subjekt i deklarimit vjetor të të ardhurave.
- Njoftim për afatin e deklarimit të vendimit të ortakut.
- Njoftim mbi afatin e fundit të pagesës së dividendit.

Sipas planit në vitin 2017 është bërë evidentimi i tatimpaguesve më problematik dhe ndjekja e tyre për sistemim të situatës dhe tatimpagues të veçantë të konsideruar me risk dhe korigjimi i situatës së tyre tatimore. Sipas analizës paraprake të riskut bazuar në tregues fiskalë e financiarë sipas një database me të dhëna financiare të subjekteve palë të lidhura janë përzgjedhur 10 shoqëri nga DTM dhe 8 shoqëri nga DRT Tiranë për plotësimin dhe dorëzimin e dokumentacionit të plotë të transferimit të çmimit sipas udhëzimit përkatës. Pas dorëzimit të dokumentacionit të transferimit të çmimit nga këto subjekte me risk të lartë janë hapur dosje për secilin prej tyre.

Gjatë vitit 2017 është mundur krahasimi i të dhënave me doganën apo dhe kryqezimi i librave të shitjes dhe blerjes në sistemin C@TS. Kjo i ka ardhur në ndihmë cdo inspektori që kryen kontrolle në Drejtorinë e Kontrollit në Drejtoritë Rajonale. Në varësi me subjektet që kontrollohen mbështetur në programin e kontrollit për të gjitha rastet që subjektet kanë aktivitet import eksport, në të gjitha raportet e analizuara evidentohen nga ana e inspektorit që kryen kontrollin trajtohen sipas periudhave të kontrollit edhe mospërputhjet tative doganë duke bërë edhe vleresimit dhe sistemimet përkatëse.

Përzgjedhja për Kontroll

Në zbatim të Ligjit Nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, neni 80, Kontrolli Tatimor, është hartuar dhe Manuali i Kontrollit Tatimor, sipas të cilit përcaktohet dhe përzgjedhja e tatimpaguesve për kontroll dhe plani mujor i tyre.

Përzgjedhja e tatimpaguesve për kontroll hartohet nga Drejtoria e Menaxhimit të Riksit pasi ka bërë seleksionimin e tatimpaguesve të cilët rezultojnë me risk sipas modulit të Riskut.

Rezultatet e kontrolleve sipas DRT

Lidhur me rezultatet e kontrolleve tatimore të realizuara gjatë periudhës 12 mujore Janar-Dhjetor 2017, janë realizuar treguesit e mëposhtëm:

Janë planifikuar për kontroll **2,110 tatimpagues** dhe janë kontrolluar **2,080 tatimpagues** në 14 DRT-të gjatë 12 mujorit vitit 2017. Shprehur ndryshe janë realizuar 98.6 % e kontrolleve të planifikuara.

Në total si DPT janë kryer kontrolle në **2080 tatimpagues** me zbulime gjithsej në shumën 10.769.897 mijë lekë.

Tabela 11. Realizimi i planit të numrit të kontrolleve për periudhën vitin 2017, sipas DRT-ve

Nr	DRT	Kontrolle e planifikuara 12 mujori 2017	Kontrolle te perfunduara 12 mujori 2017	% e realizmit të kontrolleve
1	Berat	95	100	105%
2	Dibër	40	53	133%
3	Durrës	279	279	100%
4	Elbasan	161	170	106%
5	Fier	195	209	107%
6	Gjirokastrë	59	71	120%
7	Korçë	99	121	122%

8	Kukës	13	15	115%
9	Lezhë	31	40	129%
10	Sarandë	47	57	121%
11	Shkodër	150	169	113%
12	Vlorë	91	73	80%
13	Tiranë	670	516	77%
14	VIP	180	207	115%
	Totali	2110	2080	98.6%

Planet sektoriale të ndjekura nga Drejtoria e Kontrollit

Gjatë 2017 AT u angazhua në zhvillimin e 3 projekteve sektoriale. Në themel të projekteve sektoriale ishte përpunimi i një strategjie veprimesh me tatimpaguesit, në përputhje me sjelljet e tij historike në respektimin e detyrimeve të tyre ligjore. Tri projektet sektoriale që janë zhvilluar gjatë vitit 2017 janë:

1. Plani Sektorial i Shëndetësisë
2. Plani Sektorial i Tregtisë
3. Plani Sektorial i Turizmit

Rezultatet e planeve sektoriale të përmbledhura përkatësisht janë si më poshtë:

Planet sektoriale	Arritjet
Plani Sektorial i Shëndetësisë	<ul style="list-style-type: none">- 1,037 tatimpagues u kontaktuan nga DRT- 894 tatimpagues u kontaktuan nga qendra e thirrjeve- 67 seanca / seminare informuese të zhvilluara, 708 subjekte morën pjesë në takime- Deklarimi në kohë i TFTH u përmirësua (nga 97,2% në 2016, në 99,3% në 2017) 40% u rritën të ardhurat të deklaruar nga 2016 në 2017- 5% u rrit fitimi i tatueshëm- 6% Rritja e numrit të kuponave nga Janar-Mars 2016 në Janar-Mars 2017- 518 vizita fiskale- 177 kontrolle nga zyra- 19,503,078 Lek janë detyrimet tatimore për vizita fiskale dhe kontrolle nga zyra- 35 kontrolle të plota dhe detyrimet tatimore që rezultojnë janë 33,615,926 Lek
Plani Sektorial i Tregtisë	<ul style="list-style-type: none">- 13,440 subjekte janë kontaktuar dhe informuar në takime

	<p>dhe verifikime</p> <ul style="list-style-type: none"> - 22,612 subjekte janë kontaktuar nga Qendra e Thirrjeve - 19,600 kishin marrë njoftim nga administrata tatimore - 8% është rritur numri i deklaruesve të TTHF nga viti 2016 në vitin 2017 - 67% janë rritur të ardhurat nga TTHF nga viti 2016 në vitin 2017 - 3% është rritur numri i kuponave nga muaji janar 2017 në muajin shkurt 2017 - Kanë përditësuar të dhënat në QKB dhe kanë saktësuar llojin e aktivitetit 756 subjekte - Kanë ndryshuar përgjegjësinë tatimore 833 subjekte
Plani Sektorial i Turizmit	<ul style="list-style-type: none"> - 1,133 është numri i vizitave fiskale të zhvilluara ku detyrimet tatimore rezultuan në 4,921,000 Lek - 779 kontrolle nga zyra me detyrime tatimore 7,088,000 lekë. - Krahës tyre janë bërë dhe 834 verifikime në terren, të cilat përfshijnë dhe monitorime të xhiros së tatimpaguesve. - Janë kryer dhe 31 kontrolle të plota me gjetje në total 66,247,047 lekë. - 1,002 tatimpagues ndryshuan përgjegjësinë tatimore - 14% është rritur qarkullimi për periudhën Qershor - Korrik -Gusht 2017 vs të njëjtës në 2016-ën. - 1,510 monitorime të xhirove, nga ku rivlerësimet janë në vlerë 227,766,725 Lek
Aksioni kundër Informalitetit	<ul style="list-style-type: none"> - 19,877 tatimpagues janë kontrolluar nga Drejtoritë Rajonale - 3,738 mln lekë janë detyrimet tatimore nga kontrollet - 1,724 tatimpagues kanë ndryshuar përgjegjësinë tatimore (814 tatimpagues me TVSH)

V. MENAXHIMI I RISKUT

Qëllimi i vlerësimit të riskut dhe menaxhimit të tij, ka në fokus zhvillimin e sistemit të analizës së riskut në linjë përputhshmërie me vendet e BE/OECD, e njohur si Compliance Risk Managemant Strategy (CRMS).

Modeli i Riskut Tatimor është një model shumë dimensional, i cili shqyrton risqet e mos-përbushjes në 3 perspektiva.

- Në perspektivën e parë, rregullat e riskut analizojnë performancën relative të çdo tatimpaguesi ndër vite për deklarimin dhe pagesën e detyrimeve tatimore të regjistruara.
- Në perspektivën e dytë, performanca e çdo tatimpaguesi krahasohet me mesataren e performancës së sektorit ku tatimpaguesi ushtron aktivitetin ekonomik.
- Në perspektivën e tretë, performanca e sektorit ekonomik krahasohet me performancën e të njëjtit sektor në rajone të ndryshme dhe në rang kombëtar.

Gjatë vitit është analizuar performanca sektoriale me qëllim identifikimin e sektorëve me risk. Sektorët e identifikuar u miratuan me vendime të Komitetit të Përbushjes.

Planet sektoriale për Shërbimet Mjekësore, Tregtinë dhe Turizmin

Tabela 12. Sektorët me Risk për të gjitha Drejtoritë Rajonale

	<i>Pjesa që zë në pikët totale të riskut</i>	<i>Pjesa që zë në pikët e rregullave të thyera</i>	<i>Shpërndarja e pikëve totale të riskut tatimor sipas llojit të taksës</i>			
			<i>Risqet për TVSH</i>	<i>Risqet për Tatim Fitimin</i>	<i>Pagat</i>	<i>Të tjera</i>
Tregti me pakicë	15.52%	25.57%	20.78%	78.61%	0.34%	0.18%
Tregti me shumicë	15.60%	13.06%	61.51%	35.39%	2.28%	0.82%
Hotele, Restorante	2.07%	8.78%	28.46%	57.46%	12.54%	1.22%
Profesionet e lira	5.81%	7.02%	53.80%	39.27%	4.64%	2.23%
Agrikultura	0.46%	6.95%	55.91%	42.53%	1.02%	0.46%
Ndërtime publike	8.01%	5.73%	57.61%	37.48%	3.33%	1.57%

Analiza e përgjithshme mbi shpërndarjen e riskut në rajonet tatimore dhe në sektorët ekonomikë prioritarë u hartua duke u mbështetur në rezultatet e gjeneruara nga kriteret e riskut, për numrin e kriterëve të thyera, si dhe tatimin e rrezikuar të llogaritur nga të gjithë kriteret, për secilin tatimpagues. Nga kjo analizë u hartuan planet sektoriale për shërbimet mjekësore dhe sektorin e tregtisë.

Gjithashtu në kuadër të Planit të Masave për Sezonin Turistik Veror 2017, bazuar në ndarjen e zonave potenciale turistike sipas Drejtorive Rajonale, u analizuan treguesit e Riskut sipas DRT-ve ku ushtrohen aktivitete të lidhura me Turizmin Bregdetar dhe Malor (Bazuar dhe në klasifikim e UNËTO për Sektorët e lidhur me aktivitetin e Turizmit). Janë përfshirë në analizë sektorët: **Shitje me Shumicë, Hotele dhe Restorante, Shitje me Pakicë, Transport, Sporte aktivitete shplodhëse dhe argëtuese, Ushqim pije dhe duhan për DRT Durrës, DRT Vlorë, DRT Korçë, DRT Shkodër, DRT Sarandë, DRT Lezhë, DRT Gjirokastrë dhe DRT Berat.**

Me qëllim identifikimin e tatimpaguesve me risk DMR ka analizuar në nivel Sektori dhe Drejtorie Rajonale Pikët e Riskut dhe Numrin e Subjekteve me Risk për periudhën Maj 2016-Maj 2017. Janë analizuar 3,906 Tatimpagues me Risk në Maj 2017 dhe janë krahasuar treguesit me periudhën Maj 2016.

Nga analiza e Rregullave që thyhen më shpesh sipas Drejtorive Rajonale u vu re se për të gjitha Drejtoritë mbi 70% e Pikëve të Riskut shkaktohet nga Rregullat në Tabelën 5, ku peshën më të madhe (50%) e kanë rregullat **TCTPR dhe TPBPR.**

- **TCTPR-Nëndeklarim i xhiros për efekt TVSH-je**
 - **TPBPR-Shitje me marzh shumë të ulët fitimi**
 - **(Ka një rritje me 18% të Tatimit të Rrezikuar për Rregullin TPBPR nën Hipotezën “Shitje me marzh shumë të ulët Fitimi” nga Maj 2016 në Maj 2017.)*
- $$(Blerje/SHitje)_t - (Blerje/SHitje)_l > GAP$$

Vihet re një rritje në Pikët e Riskut në tërësi për 6 sektorët e marrë në analizë me 53%. Rritja më e madhe vihet re në Sektorin Hotele dhe Restorante me 129%, duke vijuar më pas me Sektorin e

Transportit (77% rritje) dhe Sektorin Shitje me Pakicë(73% rritje). Përsa i përket numrit të subjekteve me Risk vihet re një rritje për të gjithë Sektorët, rritje me 35% e numrit të subjekteve me Risk ose me 993 subjekte për të njëjtin set rregullash.

Tabela 13. Pikët e riskut sipas sektorëve

Sektori	Pikë Risku Maj 2016	Nr subjekteve Maj 2016	Pikë Risku Maj 2017	Nr subjekteve Maj 2017	Ndryshimi në Pikët e Riskut	Ndryshimi në Nr e subjekteve me Risk
Shitje me Shumice	2,621	812	3,487	954	33%	17%
Transport	1,183	251	2,096	365	77%	45%
Shitje me Pakicë	1,025	1151	1,774	1614	73%	40%
Hotele dhe Restorante	260	396	595	588	129%	48%
Ushqim, Pije dhe Duhan	466	169	552	243	18%	44%
Sporte dhe Aktivitete	57	24	84	32	49%	33%
Total	5,611	2,803	8,588	3,796	53%	35%

Implementimi në modulin e Riskut i rregullave të reja nga të dhënat e doganave

Përgjatë vitit 2017 u implemetuan në Modulin e Riskut 3 rregulla të reja risku që marrin në analizë të dhëna që merren nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

1. Rregulli për importet evidenton diferencat në vlerë të importeve të deklaruar nga tatimpaguesit në sistemin tatimor krahasuar me të dhënat në sistemin doganor
2. Rregulli për eksportet evidenton diferencat në vlerë të eksporteve të deklaruar nga tatimpaguesit në sistemin tatimor krahasuar me të dhënat në sistemin doganor
3. Rregulli që evidenton tatimpaguesit me status Pasiv në administratën tatimore, ndërkohë bazuar në të dhënat e sistemit doganor ky tatimpagues kryen importe.

Bazuar në të dhënat që gjenerojnë këto 3 rregulla, janë dërguar në mënyrë periodike listat me tatimpaguesit DRT-ve përkatëse.

Analiza e riskut të mosdeklarimit dhe raportimit jo të saktë

Objektiv kyç i Planit Strategjik si dhe atij Operacional për Menaxhimin e Riskut është identifikimi, vlerësimi dhe trajtimi i risqeve në të ardhurat tatimore mbështetur në strategjinë e re të përmbushjes.

Janë analizuar të dhënat e të gjithë popullatës së tatimpaguesve të regjistruar në nivel kombëtar. U gjeneruan nga sistemi C@TS të gjitha transaksionet e “Blerjeve” dhe “Shitjeve” të tatimpaguesve.

Për të mundësuar trajtimin në grupe me risk të ngjashëm, u klasifikuan tatimpaguesit duke i ndarë sipas çdo DRT-je.

Nga kjo analizë u evidentuan:

- 1.998 subjekte tatimpaguese Pasiv që rezultojnë blerës në subjekte Aktive
- 1.375 subjekte tatimpaguese Aktiv që rezultojnë shitës në subjekte Pasive
- 98 subjekte tatimpaguese Pasiv që rezultojnë shitës në subjekte Aktive

Janë analizuar të dhënat e marra nga sektori i kasave fiskale nga të cilat u evidentuan:

- 470 subjekte tatimpaguese me status "pasiv" që lëshojnë kupona tatimore
- 537 subjekte tatimpaguese me status "kërkesë për çregjistrim" që lëshojnë kupona tatimore
- 68 subjekte tatimpaguese me status "çregjistruar" që lëshojnë kupona tatimore

Bazuar në modulit e riskut u dërgohen DRT-ve planet mujore të kontrollit me subjektet me risk.

U analizuan të dhënat nga pajisjet fiskale dhe deklaratat mujore të TVSH-së për subjektet që kaluan pragun e qarkullimit për tju ndryshuar përgjegjësia tatimore dhe ju dërguan DRT-ve listat përkatëse.

Gjithashtu, përgjatë vitit 2017 me asistencën e FMN-së u punua për ndërtimin e regjistrit të riskut dhe profileve demografike të tatimpaguesve me status aktiv. Duke u bazuar në indikatorët e përmbushjes është bërë identifikimi i risqeve dhe është në proces vlerësimi i tyre

VI. MBLEDHJA ME FORCË

Në zbatim të detyrave operacionale, menaxhimi i borxhit gjatë vitit 2017 është mbështetur në objektivat strategjikë dhe është përqëndruar në garantimin e mbledhjes së detyrimeve të prapambetura, duke siguruar respektimin e të drejtave të tatimpaguesve, uljen e ekspozimit ndaj rreziqeve që lidhen me mbledhjen e detyrimeve të prapambetura dhe në të njëjtën kohë, evidentimit sa më real të gjendjes së borxhit tatimor, bazuar në të dhënat e dërguara nga Drejtoritë Rajonale Tatimore, sipas evidencave që raportohen çdo muaj nga ana e tyre.

Ecuria dhe gjendja e detyrimeve tatimore të papaguara në afat deri në 31 Dhjetor 2017 paraqitet si më poshtë:

Stoku i borxhit	Në mld lekë
Gjendja e detyrimeve të papaguara në afat në datë 01.01.2017	147.1
Gjendja në datë 31 Dhjetor 2017	95.5
Në proces gjyqësor	10.9
Totali	84.6

Gjatë periudhës së marrë në analizë, borxhi tatimor ka pësuar një rënie prej 51.6 mld lek në krahasim me fillimin e vitit ose thënë ndryshe është ulur stoku i borxhit me 35%. Në të gjitha Drejtoritë Rajonale Tatimore borxhi gjatë këtij viti ka pësuar rënie.

Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar borxhi tatimor ka një përmirësim të ndjeshëm si në arkëtime, sistemime apo dhe me pak detyrime të shtuara gjatë vitit 2017.


- **Për këtë vit janë arkëtuar 21.7 mld dhe janë sistemuar 17.5 mld Lek. Gjatë vitit 2017 janë arkëtuar 2.9 mld më shumë detyrime se viti 2016 si dhe janë sistemuar 6.3 mld Lek, më shumë.**
- Detyrimet e shtuara për vitin 2017 janë 35% më pak se detyrimet e shtuara gjatë vitit 2016.

- Gjendja e detyrimeve të papaguara të cilat ndiqen deri më 31 Dhjetor 2017 rezulton 95.5 mld lek ose 35 % më pak krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2016.
- Në borxhin prej 95.5 mld lekë është e përfshirë edhe vlera prej 10.9 mld Lek e cila është në proces gjyqësor, që deri në fund të Dhjetor 2017 zë 11% të stokut të borxhit.


Borxhi sipas llojit të tatimit

Në stokun e borxhit të ndarë sipas llojit të tatimit, TVSH zë peshën më të madhe me 36%, e ndjekur nga Tatim Fitimi me 28%, zëri Të Tjera me 22%, Sigurimet Shoqërore & Shëndetësore me 12% dhe TAP me 2%.

Grafik 2. Struktura e borxhit tatimor




Grafik 3. Borxhi sipas llojit të Tatimit 2016 vs 2017



Krahasuar me fundin e vitit 2016, gjatë këtij viti, rënie të ndjeshme ka patur në zërin Të Tjera ku borxhi është ulur me 21.5 mld lek ndërsa tatimet e tjera janë ulur përkatësisht TVSH me 17.5 mld, Tatim Fitimi me 8.1 mld, Sigurimet Shoqërore & Shëndetësore me 3 mld dhe TAP me 1.5 mld lek.


Grafik 4. Mosha e borxhit



Në total stokun e borxhit 95.5 mld lekë, borxhi sipas vjetërsisë paraqitet si më sipër ku:

- *borxhi deri në 3 muaj 13% ndaj totalit të stokut*
- *borxhi nga 3 - 6 muaj 5 % ndaj totalit të stokut*
- *borxhi nga 6-12 muaj 11 % ndaj totalit të stokut*
- *borxhi nga 1-2 vjet 24% ndaj totalit të stokut*
- *Borxhi me vjetërsi mbi 2 vjet është 48% ndaj totalit të stokut në vlerë 45.5 mld Lek*

Grafik 5. Borxhi sipas statusit të tatimpaguesit



- Subjektet Aktive zënë 45% të numrit total të subjekteve debitore me një vlerë prej 44,9 mld lek ose 47% të masës totale të borxhit.
- Subjektet Pasive zënë 55 % të numrit total të subjekteve debitore me një vlerë prej 50,6 mld lek ose 53% të masës totale të borxhit.

Ligji i Faljeve

Ligji Nr. 33 / 2017 për faljen e detyrimeve tatimore u hartua dhe hyri në fuqi në 06.05.2017. Ligji parashikonte pagesën dhe fshirjen/shuarjen e detyrimeve tatimore të papaguara me kusht apo pa kusht për periudhat tatimore të përcaktuara nga Ligji.

Tabela 14: Pasqyra përmbledhëse e faljeve automatike dhe manuale

Lloji i faljes	Nr i Tatimpaguesve	Detyrim principal	Gjobë Pagesë e	Kamatë vonesë	Gjoba Inspektori	Gjoba per deklarim te	Totali
Automatike	169,060	8,215,822,179	5,793,461,591	7,946,794,299	8,639,896,935	6,304,313,365	38,215,544,245
Pa kusht	129,211	5,604,695,757	3,098,286,752	6,904,208,998	6,805,436,102	6,304,313,365	28,716,940,974
Me kusht	19,873		2,695,174,839	1,042,585,301	1,834,460,833		5,572,220,973
Per te cregjistruarit	11,458						1,315,255,876
Kompensim nga kredia	8,518	2,611,126,422					2,611,126,422
Manuale	25,594	5,766,063,730	5,703,402,595	3,180,802,510	1,504,966,999		16,155,235,834
Pa kusht	10,959	1,954,284,008	1,998,278,875	846,340,736	959,991,539		5,758,895,158
Me kusht	14,635	3,811,779,722	3,705,123,720	2,334,461,774	544,975,460		10,396,340,676
Total falje	194,654	13,981,885,909	11,496,864,186	11,127,596,809	10,144,863,934	6,304,313,365	54,370,780,079

Në ndryshim nga ligjet e mëparshme, Ligji Nr. 33 / 2017 lehtësoi në mënyrë të konsiderueshme procedurat që duhet të ndiqeshin për të përfituar nga falja, si me poshtë:

- Krijimi i mundësisë për aplikimin e faljes automatike;

- Nuk ishte e nevojshme paraqitja e një kërkesë nga ana e tatimpaguesit për të perfituar nga falja dhe për të kryer kompesimin e kredisë për mbulimin e principalit;
- Krijimi i mundësisë për kompesimin automatik të kredisë për të mbuluar detyrimin principal;
- Zbatimi i ligjit në mënyrë korrekte në një kohë të shkurtër;
- Eliminimi i abuzimeve për moszbatimin e ligjit.

Nga ligji përfituan të gjithë tatimpaguesit që kishin detyrime tatimore të papaguara në datën e hyrjes në fuqi të ligjit, të periudhave deri në vitin 2014, përveç tatimpaguesve që janë dënuar me vendim të formës së prerë të gjykatës për vepër penale në fushën tatimore.

Nga falja automatike në të gjitha fazat e zbatimit të ligjit të faljes/fshirjes së detyrimeve tatimore të papaguara, u falën/fshinë në mënyrë automatike në sistem 169,060 tatimpagues dhe me vlerë 38,215,544,245 lekë detyrime të papaguara.

- Në zbatim të ligjit të faljes/fshirjes u krye kompensimi i detyrimeve për principal nga teprica kreditore e cdo tatimpaguesi. Nga transferimi i kredisë përfituan 8,518 tatimpagues dhe transferimi i kredisë (Kreditë e përdorura për kompensimin e detyrimeve tatimore të papaguara) ishte në shumën 2,611,126,422 lekë.
- Për të përfituar nga falja/fshirja me kusht e detyrimeve tatimore, kryen pagesën e detyrimit principal të papaguar 5,054 tatimpagues me vlerë 2,879,933,623 lekë.
- Në zbatim të ligjit të faljes/fshirjes së detyrimeve, u falën/fshinë detyrimet tatimore të papaguara të tatimpaguesve të çregjistruar në QKB por që kishin mbetur të pa çregjistruar në administratën tatimore, për shkak të detyrimeve të papaguara. Në këtë fazë u falën/fshinë detyrimet e papaguara të 11,458 tatimpaguesve për një shumë prej 1,315,255,876 lekë.
- Për zbatimin e Ligjit të faljes krahas faljes automatike u kryen edhe falje manuale për shkak të specifikave që paraqesnin detyrimet tatimore në sistemin informatik dhe jashtë tij, nga e cila përfituan 25,594 tatimpagues me një vlerë prej 16,155,235,833 lekë.

- Nga faljet manuale pa kusht përfituan 10,959 tatimpagues në vlerën 5,758,895,158 lekë. Në këtë vlerë përfshihet edhe falja/fshirja e detyrimeve të papaguara të akcizës të periudhës para datës 31.12.2010, prej 4,067,500,029 lekë.
- Nga falja manuale me kusht e detyrimeve tatimore të papaguara të regjistruara në sistemin C@TS përfituan 14,635 tatimpagues me një vlerë prej 10,396,340,676 lekë.
- Në të gjitha fazat e zbatimit të ligjit të faljes/fshirjes së detyrimeve tatimore të papaguara, u falën/fshinë në mënyre automatike dhe manuale gjithsej 54,340,780,079 lekë detyrime të papaguara dhe përfituan 194,654 tatimpagues .

VII. PERFORMANCA TEKNIKO-LIGJORE

Garantimi dhe zbatimi me paanshmëri i ligjit në mënyrë të tillë që çdo akt administrativ dhe dokument zyrtar që trajton Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, të jetë i mbështetur në Legjislacionin Tatimor dhe ligjet e tjera të zbatueshme në Republikën e Shqipërisë, është parim primar për vetë institucionin. Nga Drejtoria Ligjore dhe Teknike janë trajtuar 3107 shkresa për të siguruar një informacion të plotë, të kuptueshëm në kohë dhe të aksesueshëm në lidhje me përmbushjen vullnetare.

- Në ndërfaqen e tatimeve (<https://www.tatime.gov.al/c/8/45/lajme>) janë publikuar 17 njoftime lidhur me rritjen e ndërgjegjësimit publik duke ndihmuar në zhvillimin e kulturës për përmbushje vullnetare më të lartë dhe kuptimin e rolit të Administratës Tatimore në shoqëri. Janë përgatitur dhe publikuar në ndërfaqen e tatimeve (<https://www.tatime.gov.al/c/8/129/133/vendime-gjyqsore-te-formes-se-prere>) 4 buletine për të garantuar informimin e tatimpaguesve. Nga këto, 2 buletine kanë të bëjnë me vendimet e gjykatave për raste të lidhura me çështjet tatimore dhe 2 buletine teknike të administratës tatimore, që kanë të bëjnë me raste specifike dhe orientime për zbatimin e legjislacionit tatimor (Përfshirë edhe në buletin, 16 qëndrime/opinione).
- Janë percjellë zyrtarisht tek MFE - Propozime për ndryshime në ligjin për procedurat tatimore; Ligji për shuarjen/fshirjen e detyrimeve tatimore etj.

Ndryshimet ligjore kanë eliminuar mjaft procedura të paqarta, i kanë ardhur në ndihmë tatimpaguesit nëpërmjet lehtësimit të tyre si dhe kanë përmirësuar administrimin tatimor, në veçanti detajimi qoftë dhe nëpërmjet shëmbujve konkretë, e ka bërë legjislacionin më të qartë në zbatim dhe praktikë.

Të gjitha ndryshimet janë rezultat edhe i eksperiencave të hasura në vite apo propozimeve nga shoqatat apo grupet e biznesit, si dhe përvetësimi i shëmbujve pozitivë nga shtetet anëtare të Bashkimit European, duke i paraprirë kështu dhe përafrimit të Legjislacionit Tatimor midis Shqipërisë dhe Bashkimit European.

Drejtoria Ligjore dhe Teknike ka marrë masa në përmirësimin e përfaqësimit cilësor në konfliktet gjyqësore, përgatitjen e provave dhe prapësimeve etj.

- Administrata tatimore është përfaqësuar profesionalisht në 181 çështje gjithsej, nga të cilat 179 çështje janë të lidhura me marrëdhënie pune dhe 3 çështje kanë të bëjnë me marrëdhënie të ndryshme kontraktuale, të fituara nga ana jonë. Ndërsa Drejtoritë Rajonale të cilat përfaqësojnë administratën tatimore në 810 çështje nga të cilat 602 të fituara, çështje të cilat lidhen me tatimpaguesit.

IX. TEKNOLOGJIA E INFORMACIONIT

Mbajtja në funksion e sistemit të ri tatimor

- Drejtoria TIK asistoi palën furnitore për instalimin dhe konfigurimin e gjithë ndryshimeve në sistemet C@TS dhe “Tatimet e mia” .
 - Drejtoria TIK asistoi për identifikimin e problemeve, konceptimin dhe realizimin e zgjidhjes së problemeve të shfaqura gjatë funksionimit të sistemit.
 - Për të gjitha shtesat dhe ndryshimet e bëra në aplikime është marrë pjesë në hartimin e kërkesave, planeve të testimit dhe në procesin e testimit të funksionaliteteve të sistemit.
1. Implementimi në sistemin e ri të shkëmbimit elektronik të të dhënave:
 - Shkëmbimi elektronik i të dhënave me sistemin e thesarit.
 - Shkëmbimi i sistemit të ri të tatimeve me sistemin e QKB.
 - Përmirësimi dhe dërgimi elektronik i të dhënave të listëpagesave dhe pagesave të kryera për kontributet në ISSH.
 - Shkëmbimi elektronik i të dhënave me sistemin e Inspektoriatit Qëndror
 - Krijimi i aksesit për inspektorët tatimore pranë zyrave të ADISA-s
 - Marrja në sistemin e ri të të dhënave importeve dhe eksporteve të kryera nga tatimpaguesit nëpërmjet DPD.
 2. Ndërtimi i raporteve standarte në sistemin CATS dhe ndërtimi i raporteve ad-hoc
 3. Implementimi dhe mbajtja në funksion e sistemeve të tjera informatike në ndihmë të tatimpaguesve dhe administratës tatimore
 - Sistemi M-TAX

- Pjesëmarrja në projektin e 209 shërbimeve
- Ofrimi në portalin e-albania të pagesës elektronike
- Harta e tatimpaguesve
- Mirëmbajtja e sistemit të pajisjeve fiskale
- Mirëmbajtja e sistemit të Qendrës së Thirrjeve
- Mirëmbajtja e faqes WEB të tatimeve

X. RIMBURSIMI I TVSH-SË

Kërkesat për rimbursim të TVSH-së trajtohen dhe miratohen nga Drejtoria e Rimbursimit të TVSH-së në DPT (DRTVSH), në bashkëpunim me DRT-të nëpërmjet një procedure të përcaktuar, të fokusuar në analizën e riskut për rimbursim, sipas të cilës jo çdo kërkesë për rimbursim i nënshtrohet procedurave të kontrollit tatimor.

Drejtoria e Rimbursimit të TVSH-së në DPT, në bashkëpunim me DRT-të gjatë vitit 2017 ka analizuar dhe trajtuar kërkesat për rimbursim të TVSH-së në përputhje me Ligjin 9920 datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe në Udhëzimin nr 24, datë 02.09.2008 “Për Procedurat Tatimore në RSH”, i ndryshuar si dhe me Ligjin Nr. 92/2014 “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

Legjislacioni tatimor parashikon që një person i tatueshëm kërkon të drejtën e rimbursimit të tepricës së kreditimit tatimor të TVSH-së nëse:

- a) personi i tatueshëm ka mbartur tepricën e TVSH-së së zbritshme për 3 muaj radhazi, sipas pikave 2 dhe 3, të nenit 76, të ligjit nr 92/2014 “Për TVSH-në”; dhe
- b) TVSH-ja e kërkuar për t’u rimbursuar tejkalon shumën prej 400 000 (katërqind mijë) lekësh.

Afatet ligjore të rimbursimit:

- Brenda 60 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës së tatimpaguesit (jo eksportues).
- Brenda 30 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës së tatimpaguesve eksportues, drejtoria rajonale e tatimeve verifikon situatën tatimore të tatimpaguesit, ushtron kontroll bazuar në analizën e riskut dhe miraton tepricën kreditore si të rimbursueshme.

Lehtësirat në procedurë për kategorinë e eksportuesve

- a) Vlera e eksporteve të kryera në periudhën/at tatimore, për të cilën/at kërkohet rimbursim, është më shumë se 70% e vlerës së përgjithshme të shitjeve, përfshirë eksportet dhe që plotësojnë dhe disa kritere të tjera **rimbursohen automatikisht brenda 30 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës për rimbursim të TVSH-së, si persona me risk zero.**
- b) Personat e tatueshëm, vlera e eksporteve të të cilëve, të kryera në periudhën/at tatimore për të cilën/at kërkohet rimbursimi, **përbën më shumë se 50% deri në 70%** të vlerës së përgjithshme të shitjeve, përfshirë eksportet, rimbursohen brenda 30 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës për rimbursim të TVSH-së, **duke iu nënshtruar më parë procedurës së analizës së riskut.**
- c) **Të gjithë personat e tjerë të tatueshëm që kryejnë eksporte, por nuk klasifikohen në pikat 1 dhe 2 më sipër, rimbursohen brenda 60 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës për rimbursim duke iu nënshtruar procedurës së analizës së riskut.”.**

Përveç bazës ligjore të përcaktuar ekziston një bazë dokumentare mbi të cilën punon tashmë Drejtoria e Rimbursimit si më poshtë:

- Rregullorja e Brendshme e Drejtorisë;
- Rregullorja “Për rimbursimin e TVSH-së” mbështetur në analizën e riskut e datës 13.01.2017;
- Manuali i Drejtorisë së Rimbursimit , i datës 05.02.2017;
- Plani Operacional i Drejtorisë së Rimbursimit.

Nëpërmjet Manualit u arrit që të sigurohej kuadri i nevojshëm rregullator dhe lehtësimi dhe zbatimi me përpikmëri i legjislacionit tatimor në fushën e rimbursimit të TVSH-së si dhe unifikimi i procedurave të ndjekura lidhur me trajtimin e praktikave.

Theksojmë se një dokument mjaft i rëndësishëm në punën e kësaj drejtorie është rregullorja për rimbursimin e TVSH-së mbështetur në analizën e riskut ku qëllimi i saj kryesor është vendosja e

rregullave dhe procedurave që duhet të ndjekin Drejtoria e Rimbursimit, Drejtoria e Menaxhimit të riskut dhe DRT-të që janë të përfshira në procesin e rimbursimit të TVSH-së.

Trajtimi i kërkesave bëhet brenda 2 ditëve nga data e marrjes së kërkesës duke mbajtur një Akt evidentimi në të cilin përshkruhet hollësisht evidentimi dhe plotësimi i kriterëve për të pranuar ose jo kërkesën për rimbursim.

Në varësi të rezultatit të analizës paraprake nga Drejtoria e Rimbursimit të TVSH-së është bërë pranimi ose mospranimi i kërkesave për rimbursim të TVSH-së.

Gjatë vitit 2017 nga DRTVSH ka vazhduar procedura e rimbursimit për 147 kërkesa me vlerë 6,1 miliardë lekë të mbartura nga viti 2016, ku peshën më të madhe e kanë pasur tatimpaguesit Trans Adriatic Pipeline me vlerë 3,1miliard lekë, Kurum në vlerë 186 milion lekë, Colacem në vlerë 160 milion lekë, Elbasan Cement Factory në vlerë 127 milion lekë, Albchrome në vlerë 227 milion lekë ose 60% të totalit të kërkesave të mbartura.

Tabela 15. Situata e rimbursimit për kërkesat e mbartura nga viti 2016 deri në fund të vitit 2017

	Nr	Vlerë (000/ lekë)
Kërkesa	147	6,109,131
Miratuar	113	4,886,060
Nga këto:		
rimbursuar/kompensuar	113	4,641,746
<i>me rimbursim Cash</i>		3,790,363
<i>me kompensim</i>		851,383
Pa kontrolluar	3	525,142
Refuzuar	6	77,960
Tërhequr nga kërkesa	0	0

Efekti i kontrollit për kërkesat e mbartura nga viti 2016 është në vlerë absolute 285 milion lekë ose 11.6%.

Tabela 16. Pesha specifike e DRT në dhënien e rimbursimit për kërkesat e mbartura nga viti 2016 të rimbursuara nëpërmjet sistemit të thesarit brenda datës 31.12.2017

DRT	Rimbursime për kërkesa të vitit 2016 (000 lekë)		
	Kompensim	Rimbursim DPT	Total
Berat	1,269	45,331	46,600
Dibër	0	0	0
Durrës	14,234	151,073	165,307
Elbasan	1,920	2,012	3,932
Fier	39,639	140,972	180,611
Gjirokastrë	2,928	14,905	17,833
Korçë	15,120	7,851	22,971
Kukës	17,247	16,933	34,180
Lezhë	141	2,490	2,631
Sarandë	784	9,449	10,233
Shkodër	301	58,561	58,862
Vlorë	24,500	24,952	49,452
Tiranë	57,372	249,447	306,819
DTM	675,928	3,066,388	3,742,316
TOTAL	851,383	3,790,364	4,641,746

Gjithashtu gjatë vitit 2017 pranë DRTVSH-së janë paraqitur gjithsej 1308 kërkesa, nga të cilat janë refuzuar për mosplotësim të kriterëve ligjore 366 kërkesa me vlerë 5,4 miliardë lekë dhe janë pranuar 942 kërkesa me vlerë 29,2 miliardë lekë e shprehur në përqindje rreth 25% kërkesa më shumë se viti 2016.

Tabela 17. Situata e kërkesave të paraqitura gjatë vitit 2017 sipas periudhës së depozitimit të kërkesës

	Periudha e paraqitjes së kërkesës	Nr i kërkesave që nuk plotësojnë kërkesat ligjore	Nr i kërkesave që plotësojnë kërkesat ligjore	Vlerë e kërkuar për rimbursim (000) lekë
1	Janar 2017	31	57	1,064,367
2	Shkurt 2017	33	62	5,931,372
3	Mars 2017	37	48	4,694,739
4	Prill 2017	35	94	1,150,639
5	Maj 2017	44	118	1,225,106
6	Qershor 2017	37	87	4,132,497
7	Korrik 2017	31	82	939,543
8	Gusht 2017	18	58	724,328
9	Shtator 2017	24	91	961,337
10	Tetor 2017	25	81	2,874,110
11	Nëntor 2017	23	90	4,543,226
12	Dhjetor 2017	28	74	1,577,836
	Total viti 2017	366	942	29,279,100

Në totalin e shumës së kërkuar për rimbursim gjatë vitit 2017, 30 % e zë kategoria e eksportuesve dhe fasonistëve, 46.9% kategoria e investimit, 1.01% trupi diplomatik, 22.09 % aktivitete të tjera.

Në totalin e shumës së miratuar për rimbursim gjatë vitit 2017, 36.7 % e zë kategoria e eksportuesve dhe fasonistëve, 48.5 % kategoria e investimit, 1% trupi diplomatike, 13.8% aktivitete të tjera.

Tabela 18. Situata e rimbursimit për kërkesat e vitit 2017 deri në fund të vitit 2017

	Nr	Vlerë (000 lekë)
Kërkesa	942	29,279,100

	Miratuar	843	21,808,157
Nga	rimbursuar/kompensuar	822	17,541,396
këto:	<i>me rimbursim Cash</i>		<i>13,872,274</i>
	<i>me kompensim</i>		<i>1,422,804</i>
	Pa kontrolluar	83	6,968,687
	Refuzuar	13	101,611
	Tërhequr nga kërkesa	3	77,999

Pa rimbursuar nga kërkesat e miratuara për rimbursim në fund të vitit 2017 rezultojnë 125 kërkesa për rimbursim me vlerë 12,3 miliardë lekë ku peshën më të madhe e zënë TRANS ADRIATIC PIPELINE AG në vlerë 5,4 miliardë leke, Ayen As Energji në vlerë 3,4 miliardë lekë dhe Bankers Petroleum në vlerë 0.9 miliardë lekë, ALBCHROME në vlerë 0.3 miliardë lekë ose 81 % të stokut.

Pa kontrolluar nga kërkesat e paraqitura gjatë vitit 2017 janë 83 në vlerë 6,9 miliardë lekë, ku peshën më të madhe e zënë 3 kërkesa përkatësisht TAP në vlerë 3 miliardë lekë, BANKERS 0.4 miliardë lekë lekë, Deveron Albania në vlerë 1,7 miliardë lekë.

Tabela 19. Pesha specifike që zë çdo DRT në dhënien e rimbursimit Cash për kërkesa të vitit 2017 të paguara nëpërmjet sistemit të thesarit brenda datës 31.12.2017

DRT	Rimbursime për kërkesa të vitit 2017 (milion lekë)	
	Rimbursim DPT	Nr.Tatimpaguesve
Berat	372	38
Dibër	97	7
Durrës	1,198	160
Elbasan	807	25
Fier	1,057	114
Gjirokastrë	77	9
Korçë	215	39
Kukës	39	4
Lezhë	74	11
Sarandë	34	7
Shkodër	328	40
Vlorë	170	32
Tiranë	2,587	208
DTM	6,718	120
TOTAL	13,773	814

Eshtë realizuar si aktivitet operacional kryerja e procedurës së rimbursimit automatik për tatimpaguesit eksportues të kategorizuar me risk zero sipas kriterëve përcaktuar në VKM 953 datë 29.12.2014, ku nga totali i kërkesave për rimbursim në vitin 2017, 37 kërkesa janë konsideruar me risk zero duke mos ju nënshtruar analizës së riskut e cila ka sjell përfundimin e procedurës së miratimit të rimbursimit menjëherë ndryshe nga viti i kaluar në të cilin numri i kërkesave të trajtuara me risk zero nga DRTVSH ishte i papërfillshëm krahasuar me numrin total të kërkesave për rimbursim.

Rimbursimi i TVSH vijon të mbetet një shqetësim i AT në marrëdhënien e saj me sipërmarrjen. Viti që lamë pas shënoi cilësi si në drejtim të përmirësimit të procedurës së rimbursimit

(rimbursim në bazë të riskut), uljes së numrit të kontrolleve tatimore për rimbursim dhe në drejtim të shumës së rimbursuar e më konkretisht:

- Gjate vitit 2017 pati një rritje të numrit të kërkesave për rimbursim nga 773 kërkesa në vitin 2016 në 942 kërkesa ose 25 % më shumë se viti i kaluar.
- Gjatë 2017 u rimbursuan 13.9 miliardë lekë TVSH, krahasuar me vitin e kaluar kjo shifër e shprehur në % është 56% më shumë se në vitin e kaluar apo 4.9 miliardë lekë më shumë; Krahasuar me planin e vitit 2017, janë rimbursuar 40% më shumë kërkesa.
- Gjate vitit 2016, rreth 95 % e kërkesave për rimbursim i nënshtroheshin kontrollit, ndërsa gjatë vitit 2017 kjo shifër është ulur në 75% e kërkesave,
- Gjatë vitit 2017, 25% e kërkesave është miratuar pa kontroll, praktikë kjo e bazuar në analizën e riskut implementuar në fillim të vitit 2017. Në vitin 2016 numri i kërkesave pa kontroll përbënte 5% e tyre.

Gjate punës , DRTVSH-së ka hasur problematika lidhur me mosrespektimin e afatit nga ana e Drejtorive Rajonale si për zbatimin e afateve të kontrollit, kryerjes së kompensimeve, dërgimin e akt kontrolleve me vonesa pranë DRTVSH-së etj, për të cilat në mënyrë sistematike ju tërhiqet vëmendje DRT-ve respektive si dhe janë organizuar takime dhe analiza në lidhje me mosrespektimin e afateve nga DRT-re dhe evidentimin e DRT-ve problematike si dhe masat që duhet të merren në lidhje me këtë fenomen.

Theksojmë se pavarësisht problematikave të hasura në lidhje me këtë proces edhe nga misioni i fundit i FMN-së në rekomandimet e tyre janë dhënë vlerësime pozitive dhe është vlerësuar progres në lidhje me procesin e rimbursimit ku është theksuar që:

“DPT ka prezantuar një qasje të bazuar në risk ndaj TVSH-së së Rimbursimeve, por ende nuk është plotësisht i automatizuar si dhe DPT ka përmirësuar kapacitetin e saj për të miratuar rimbursimin e TVSH-së brenda afateve të përcaktuara me ligj dhe me konkretisht ka rritur numrin e kërkesave të miratuara pa pasur nevojë për një kontroll para-rimbursimit nga 5% siç është vërejtur në kohën e vlerësimit TADAT në korrik 2016, në 36 për qind në fund të shtatorit 2017.

Megjithatë, përmirësimi i mëtejshëm është i nevojshëm të zvogëlojë kohën e marrë për të miratuar kërkesat e rimbursimit brënda një afati kohor që është më afër praktikave të mira ndërkombëtare”

Gjithashtu nga anketa e kryer nga Këshilli i investimeve me sipërmarrjen rezulton se, Citojmë: Ka një rritje të marrjes në mënyrë automatike, të rimbursimit, përmirësim i ndjeshëm i respektimit të afateve të rimbursimit, ku është rritur ndjeshëm nr i rimbursimeve brënda 30 ditëve, Në 2017 eksportuesit kanë ndjerë në mesatare një përmirësim të Afateve të Rimbursimit.

XI. MARRËDHËNIET DHE KOORDINIMI INSTITUCIONAL

Drejtoria e Marrëdhënieve dhe Koordinimit Ndërinstitucional organizon dhe koordinon marrëdhëniet dhe bashkëpunimin dypalësh të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve me organizma ndërkombëtare, në zbatim të aktiviteteve të Administratës Tatimore Shqiptare, por gjithashtu edhe në zbatim të marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara nga Parlamenti me ligj. Në çdo kohë kjo drejtori siguron zbatimin e drejtë të marrëveshjeve ndërkombëtare tatimore dhe garanton mbrojtjen e interesave të tatimpaguesve shqiptarë në raport me transaksionet dhe marrëdhëniet me administratat tatimore të huaja.

Gjatë vitit 2017 Drejtoria e Marrëdhënieve dhe Koordinimit Ndërinstitucional, në kuadër të ofrimit të shërbimeve cilësore dhe reduktimit të barrës administrative për tatimpaguesit:

- Iu është përgjigjur mbi 1600 kërkesave nga tatimpaguesit për zbatimin e marrëveshjeve tatimore ndërkombëtare për shmangien e taksimit të dyfishtë, që Shqipëria ka lidhur me 40 shtete;
- Iu është përgjigjur mbi 480 kërkesave të tatimpaguesve dhe individëve për t'u pajisur me çertifikatë rezidence;
- Ka asistuar drejtoritë e tjera brenda DPT si dhe Drejtoritë Rajonale në lidhje me probleme dhe paqartësi në zbatimin e marrëveshjeve për shmangien e taksimit të dyfishtë;
- Ka përpiluar programet e trajnimit dhe ka trajnuar stafin e ri / aktual të administratës tatimore mbi zbatimin e marrëveshjeve për shmangien e taksimit të dyfishtë.

Gjithashtu kjo Drejtori ka dhënë kontributin e vet edhe për: Pjesëmarrje në grupin e punës të ngritur në kuadër të Projektit Pilot për Shkëmbimin Automatik të Informacionit, që po zbatohet me ndihmesën e Bankës Botërore, OECD dhe Administratës Tatimore Italiane;

Pjesëmarrje në grupe pune në nivel ndërministror

Bashkëpunim i ngushtë me Ministrinë e Financave duke marrë pjesë në grupe negociatash për arritje marrëveshesh të reja ndërkombëtare për eliminimin e taksimit të dyfishtë si dhe duke dhënë mendime për akte ligjore dhe nënligjore në lidhje me çështje tatimore.

Shkëmbimi i eksperiencave dhe pjesëmarrje

- Gjatë vitit 2017, në kuadrin e shkëmbimit të eksperiencave, studimit dhe zbatimit të praktikave më të mira ndërkombëtare në lidhje me sistemet e menaxhimit, Drejtoria e Marrëdhënieve dhe Koordinimit Ndërinstitucional ka organizuar pjesëmarrjen e stafit të Administratës Tatimore në aktivitetet si vijon:
 - 10 seminare/trajnime (18 punonjës të trajnuar) organizuar nga *Organizata Ndër-Europiane e Administratave Tatimore (IOTA)* - organizatë jo-fitimprurëse ndërqeveritare që nxit bashkëpunimin ndërmjet administratave tatimore në rajonin e Evropës dhe mbështet zhvillimin e tyre në përputhje me nevojat e tyre individuale).
 - 10 seminare/trajnime (17 punonjës të trajnuar) organizuar nga *Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (OECD)* - ka për mision nxitjen e politikave në përmirësimin ekonomik dhe social të mirëqenies së njerëzve në mbarë botën)
 - 7 seminare/trajnime (10 punonjës të trajnuar) organizuar Qendra e Ekselencës Financiare (**CEF** - organizatë ndërkombëtare me mision mbështetjen e zhvillimit të kapaciteteve për zyrtarët e financave në Evropën Juglindore).
 - 4 seminare/trajnime (7 punonjës të trajnuar) organizuar në kuadër të pjesëmarrjes së Shqipërisë në programin e BE-së **Fiscalis 2020**. Gjithashtu, në kuadër të po këtij programi janë zhvilluar 3 vizita studimore pranë administratave tatimore homologe.

XII. MENAXHIMI I PROJEKTEVE

Objekti i Drejtorisë së Menaxhimit të Projekteve është ndjekja dhe koordinimi i të gjitha projekteve me financim të brendshëm apo të huaj që zhvillohen në Administratën Tatimore, që ndërlidhen me bashkëpunimin vendas apo ndërkombëtar, përfshirë: Administratat Tatimore, Organizatat Ndërkombëtare etj.

Bazuar në objektivat strategjike të Administratës Tatimore, janë përmbushur përgjatë vitit 2017 aktivitete operacionale si krijimi i mjeteve informuese, për tatimpaguesit dhe individët, pranë Shërbimit të Tatimpaguesve. Për këtë, në Tetor 2017 u nënshkrua Memorandumi i Mirëkuptimit ndërmjet DPT, ADISA dhe BERZH për ngritjen e një sporteli të veçantë informues, për tatimpagues dhe individë, pranë qendrave ADISA. Ky projekt pritet të përfundojë në vitin 2019. Gjatë vitit 2017 u mundësua nga ekspertët e kontraktuar, shqyrtimi i legjislacionit fiskal lidhur me detyrimet tatimore dhe identifikimi i autoriteteve dhe njësive të cilat duhet të japin informacionin mbi detyrimet tatimore/fiskale.

Në fokus të veçantë ka qënë dhe rritja e kapaciteteve të inspektorëve të kontrollit tatimor. Në kuadër të Projektit ‘‘Për forcimin e edukimit të kontabilitetit dhe auditimit për hartuesit e pasqyrave financiare dhe punonjësit tatimorë dhe rritja e kapaciteteve teknike të profesioneve të kontabilitetit dhe auditimit’’, përfundoi pjesa e trajnimeve parashikuar për vitin 2017. U trajnuan për raportimin financiar 100 inspektorë kontrolli dhe për standartet ndërkombëtare të kontabilitetit 85 inspektorë në trajnime një javore. Do të vijohet me trajnime edhe përgjatë vitit 2018.

Në zbatim të objektivit për mbajtjen e proceseve optimale u organizuan vizita nga ekspertë të huaj, të FMN dhe FCVC/USAID, me qëllim ofrimin e asistencës dhe praktikave më të mira ndërkombëtare për: Drejtorinë e Mbledhjes me Forcë, Drejtorinë e Menaxhimit të Riskut, Drejtorinë e Kontrollit Tatimor, Drejtorinë e Shërbimit të Tatimpaguesve, Qendrën e Thirrjeve si dhe Drejtuesit e Administratës Tatimore.

Si një projekt shumë i rëndësishëm, në Dhjetor 2017, në kuadër të bashkëpunimit dhe bashkeveprimit elektronik, u miratua nga ‘‘Agenzia Italiana per la Cooperazione allo Sviluppo’’, projekti për Shkëmbimin Automatik të Informacionit, zbatimi i të cilit fillon në Janar 2018.

XIII. QENDRA E PAGESAVE

Gjate vitit 2017 Qendra e Pagesave ka ndjekur, përgatitur dhe raportuar në kohë dhe me saktësi informacionin mbi pagesat e kryera në bankat e nivelit të dytë dhe në thesar lidhur me të ardhurat tatimore dhe kontributet e detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore. Puna e kësaj drejtorie gjatë vitit 2017 është fokusuar në:

- Marrjen dhe Krahësimin e ekstraktit bankar me të dhënat e ardhura elektronikisht nga sistemi i thesarit.
- Komunikimin me Drejtorinë e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit në funksion të mbarëvajtjes së punës dhe saktësisë së informacionit. Nr i komunikimeve elektronike për zgjidhjen e problematikave të konstatuara gjatë vitit 2017 ka qenë rreth 150.
- Sistemimin e pagesave pezull në bazë të Akt-Marrëveshjes mes Minsitrisë së Financave dhe bankave të nivelit të dytë, duke komunikuar në mënyrë permanente me bankat e nivelit të dytë dhe me tatimpaguesit. Më saktësisht, janë sistemuar 708 raste për vitin 2017.
- Përgatitjen e **raporteve** ditore, **mujore dhe progresive** të të ardhurave të tatimore dhe kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve dhe për cdo drejtori rajonale tatimore pas rakordimit të të ardhurave me bankat e nivelit të dytë dhe degën e thesarit si dhe vënja e këtyre raporteve **në dispozicion të Drejtorisë së Kontabilitetit dhe Analizes** dhe strukturave drejtuese në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve.
- Komunikimin e vazhdueshëm me bankat e nivelit të dytë në zbatim të Akt- Marrëveshjes për të gjitha sqarimet për rastet e sistemimeve të pagesave që nuk mund të identifikohen nga administrata tatimore apo të ndonjë problemi të lindur gjatë zbatimit të kësaj akt marrëveshje me bankat e nivelit të dytë. Gjate vitit 2017 janë kryer 200 komunikime elektronike me bankat e nivelit të dytë dhe me tatimpaguesit për problematika të ndryshme.

XIV. HETIMI TATIMOR

Gjatë vitit 2017 bazuar në objektivat strategjikë të hartuara dhe miratuara si dhe në zbatim të legjislacionit në fuqi, Drejtoria e Hetimit Tatimor ka punuar dhe realizuar detyrat funksionale në zbatim të performancës së administratës tatimore në funksion të mbledhjes dhe realizimit të të ardhurave buxhetore dhe parandalimit të rasteve të evazionit tatimor.

Drejtoria e Hetimit Tatimor ushtron detyrat e saj në kuadër të parandalimit, zbulimit dhe hetimit, në përputhje me ligjin e procedurave tatimore dhe legjislacionin penal apo procedural penal, të kundravajtjeve administrative tatimore apo veprave penale në fushën e taksave dhe tatimeve.

Rezultatet e Drejtorisë së Hetimit Tatimor bazuar në Manualin e Hetimit Tatimor, Rregulloren “Për funksionimin e administratës tatimore qendrore”, Ligjin Nr.9920 datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në RSH” i ndryshuar, Udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të tij, si dhe në zbatim të objektivave të Planit Strategjik 2017-2021, kanë konsistuar në këto drejtime:

1. Kryerje e kontrolleve në territorin e RSH, me qëllim ndërgjegjësimin dhe kontrollin e tatimpaguesve për kryerjen e çdo transakcioni tregtar në zbatim të ligjit duke lëshuar kuponin ose faturën tatimore, duke rritur në këtë mënyrë qarkullimin tregtar dhe nivelin e arkëtimeve.

Kryerja e kontrolleve në terren është kryer mbi bazën e planeve operacionale gjatë periudhës 12-mujore. Duke nisur fillimisht me lista të subjekteve të përcjellë nga Drejtoria e Menaxhimit të Riskut në DPT, kontrolle në zona me qarkullim të lartë të xhiros, kontrolle në bazë të planit operacional për monitorimin e zonave turistike dhe si përfundim kontrolle bazuar në planin 3-mujor kundër informalitet Tetor-Dhjetor 2017.

Gjithashtu është asistuar në terren, Drejtoria e Mbledhjes me Forcë me qëllim mbledhjen e detyrimeve të papaguara nga subjekte të përzgjedhur si problematikë në shlyerjen e detyrimeve.

2. Në bazë të objektivit strategjik, gjatë vitit 2017 Drejtoria e Hetimit Tatimor në kryerjen e detyrave funksionale ka evidentuar subjektet të cilat kanë pasur detyrime tatimore dhe për të cilat janë marrë masat administrative, po ashtu ka evidentuar raste të subjekteve të cilët kanë kryer fshehje të të ardhurave, mashtrim me TVSH-në, ose vepra të tjera penale në fushën e tatimeve dhe të taksave. Për të gjitha këto raste janë marrë masat administrative përkatëse dhe për rastet të cilat kanë përmbushur elementët e figurave të veprave penale

është bërë kallëzimi i tyre në Prokuroritë përkatëse, si dhe janë ndjekur detyrat e deleguara nga Prokuroria sipas rastit.

3. Gjatë vitit 2017 Drejtoria e Hetimit Tatimor, është angazhuar dhe ka realizuar objektivin, në lidhje me progresin organizativ të administratës tatimore dhe zhvillimin e kapaciteteve njerëzore. Në funksion të kësaj, është rishikuar dhe miratuar Manuali i hetimit tatimor, me qëllim unifikimin e praktikave të ndjekura nga Drejtoria e Hetimit.

Janë kryer disa trajnime për stafin duke u fokusuar në ndryshimet e legjislationit, manualin e drejtorisë së hetimit dhe rregulloren e funksionimit të administratës tatimore qëndrore.

Po ashtu janë përcaktuar dhe procedurat e rekrutimit, emërimit, vlerësimit dhe marrjen e masave disiplinore për punonjësit e Drejtorisë së Hetimit Tatimor.

Rezultatet e Drejtorisë së Hetimit Tatimor


Nga Drejtoria e Hetimit Tatimor, për kontrollet në terren, gjatë vitit 2017 ka këto rezultate:

- Janë kryer në total 52,702 kontrolle.
- Janë konstatuar në total 11,536 shkelje administrative (rezulton 21% e subjekteve të kontrolluar).
- Subjekte të paregjistruara 646 raste;
- Bllokime aktiviteti (kupon herë e dytë) 116 raste;
- Moslëshim kuponi tatimor 2,702 raste;
- Punonjës të paregjistruar 1,962 raste;
- Shkelje të tjera 6,110 raste ;
- Vlera e shkeljeve rezulton 469,701,977 lekë.


Paraqitja në tabelë e të dhënave :

Kontrolle	Shkelje	Vlerë/ shkelje	Subjekte të paregjistruar	Bllokime (kupon herë e II)	Moslëshim kuponi	Punonjës të padeklaru ar	Shkelje të tjera
52,702	11,536	469,701,977	646	116	2,702	1,962	6,110


Paraqitja me grafikë e të dhënave :



Grafik nr.1 Verifikime në terren sipas rajoneve



Grafik nr.2 Penalitete në numër sipas rajoneve



Grafik nr.3 Shkelje në vlerë sipas rajoneve.

Gjatë vitit 2017, Drejtoria e Hetimit Tatimor është angazhuar në parandalimin dhe zbulimin e rasteve të evazionit fiskal. Në lidhje me këtë janë arritur rezultatet si më poshtë:

Statistikë e veprave penale Janar-Dhjetor 2017

Nr	Vepra penale	Neni K.P	Nr. Ref	Vlera e dëmit	Autorë	Gjëndje të lirë
1	Krijimi i skemave mashtruese me TVSH	144/a	8	1,033,547,402	73	73
2	Fshehje e të ardhurave	180	55	2,049,803,921	58	58
3	Mospagim taksash e tatimesh	181	61	3,123,243,913	61	61

4	Organizim i Llotarive të palejuara	197	10	0	10	10
5	Punësim i paligjshëm	170/a	18	800,000	18	18
6	Të tjera		13	0	8	8
	Shuma		165	6,207,395,236	228	228

Ndarja sipas rajoneve:

Paraqitja grafikisht e të dhënave :



XV. BURIMET NJERËZORE

Drejtoria e Burimeve Njerëzore ka punuar gjatë gjithë vitit 2017 duke patur në fokusin e saj kryesor mirëmenaxhimin e burimeve njerëzore të administratës tatimore, me qëllim përmirësimin e funksionimit të saj, në kuadër të krijimit të një administrate tatimore moderne, që përdor metoda e metodologji bashkëkohore.

Implementimi i strukturës së re organizative të administratës tatimore qendrore, bazuar në Urdhrin e Kryeministrit nr. 126, datë 02.08.2016, kërkoi një angazhim shumë serioz nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe gjatë 2017 ju kushtua vëmendje e veçantë respektimit të çdo procedure ligjore dhe sistemimit të punonjësve të cilët për shkaqe ligjore kanë qenë të pezulluar gjatë periudhës së ristrukturimit të administratës tatimore.

Drejtoria e Burimeve Njerëzore ka raportuar në periudha të caktuara gjatë vitit 2017 për realizimin e objektivave të saj përcaktuar në planin operacional, miratuar me vendimin të Drejtorit të Përgjithshëm, në cilësinë e Kryetarit të Komitetit Operacional, nr. 7, datë 19.01.2018, si me poshte:

Rekrutimi dhe Promovimi

Referuar Urdhrit nr. 126 datë 02.08.2016 të Kryeministrit, struktura organizative e Administratës Tatimore, përmban 1569 numër plan punonjësish/nëpunësish, prej të cilëve 1159 janë nëpunës civil dhe 410 punonjës të cilët trajtohen nga dispozita të Kodit të Punës.

Deri në 31.12.2017 kanë qenë 974 nëpunës civil fakt dhe 380 punonjës administrativë fakt.

Gjatë periudhës janar-dhjetor 2017 janë përgatitur:

- 138 akt emërimi, gjithsej 41 emërimë në pozicione që trajtohen legjislativisht për nëpunësin civil dhe 97 akt emërimë për punonjës në pozicione që trajtohen me dispozita të Kodit të Punës, në respektim të kriterëve dhe vlerësimit, të finalizuara me nënshkrimin e kontratës midis punëdhënësit dhe punëmarrësit.
- 46 akteve transferimi, pas zbatimit të procedurave ligjore, nga DAP dhe DPT.
- 86 akteve me objekt lirim nga shërbimi civil.
- 8 akteve me objekt largim nga shërbimi civil

- 18 emëtime, në zbatim të VKM nr. 7, datë 11.01.2017 “Për përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme, për vitin 2017, në njësitë e qeverisjes qendrore”, i ndryshuar.
- 467 emëtime, VKM nr. 7, datë 11.01.2017 Lidhja 1, “Për përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme, për vitin 2017, në njësitë e qeverisjes qendrore”, i ndryshuar, punonjës shërbimi në kuadër të projektit pilot.

Gjatë 2017, nga Sektori i Rekrutimit dhe Promovimit, në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore janë trajtuar afërsisht **1831 shkresa hyrëse**, në respektim të afateve ligjore.

a) Menaxhimi i deklaratave vjetore të pasurive të stafit i administratës tatimore, duke siguruar që i gjithë stafi të cilit i kërkohet, të dorëzojë deklaratat e pasurive. Më pas deklaratat i kalohen Inspektoriatit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive, dhe Konfliktit të Interesit dhe i përgjigjet sqarimeve të Inspektoriatit në lidhje me deklaratat e pasurive;

Është mundësuar njoftimi i punonjësve të rinj të emëruar, punonjësve të cilët ndryshojnë pozicion, punonjësve të cilët largohen nga Administrata Tatimore, për detyrimin e vetëdeklarimit, si subjekte të cilët mbartin detyrimin për deklarim, si dhe mban korrespondencën me ILDKPKI.

b) Mbajtja dhe administrimi i të dhënave bazë në formë elektronike për zbatimet e vendimeve gjyqësore;

Nga ana e Sektorit të Rekrutimit dhe Promovimit, në bazë të praktikave të ardhura nga Drejtoria Ligjore dhe Teknike, për ekzekutim të vendimeve të formës së prerë, me palë ndërgjyqëse DPT dhe ish – nëpunës civil, për të cilët gjykatat kompetente kanë vendosur rikthimin e palës paditëse në pozicionin e mëparshëm të punës, ka hartuar dhe përgatitur databaze, ku ka pasqyruar çdo të dhënë të kërkuar me ligj apo të nevojshme për informimin e Komisionit të Posaçëm të ngritur me Urdhrin nr. 25, datë 24.04.2017 “Për ngritjen e Komisionit të Posaçëm për zbatimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë nga Administrata Tatimore”, në zbatim të Urdhrit të Ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike nr. 5151 datë 28.10.2015, “Për zbatimin e

vendimeve gjyqësore të formës së prerë nga institucionet e administratës publike, të përfshira në fushën e zbatimit të ligjit për shërbimin civil”.

Për periudhën maj-dhjetor 2017, janë pasqyruar në database 179 gjyqfitues, prej te cilëve, aktualisht janë shqyrtuar 56 praktika.

c) Krijimi, administrimi dhe sistemimi i dosjeve të personelit të çdo të punësuar në Administratën Tatimore

Për periudhën 1 vjeçare të vitit 2017, janë inventarizuar të gjitha dosjet personale të punonjësve faktik, duke u pajisur me fletë-inventari, si dhe janë krijuar dosje elektronike për çdo punonjës ku ndodhet i skanuar dokumentacioni që përmban dosja e personelit.

Janë rregjistruar 918 vendime të Drejtorit të Përgjithshëm në databazën e përgjithshme të burimeve njerëzore.

Për sa i përket sistemit HRMIS është realizuar hedhja e të dhënave, sa më poshtë sqarojmë:

Të dhënat bazë: 1354 punonjës

Edukimi: 1329 punonjës

Pervoja e Punës: 1346 punonjës

Janë hedhur në sistem të gjitha masat disiplinore të marra për periudhën raportuese dhe vlerësimet e punës për të gjithë punonjësit e administratës tatimore.

Është bërë raportim në DAP, për periudhat mujore (prill, maj, qershor, korrik, gusht, shtator, tetor, nëntor, dhjetor).

d) Plotësimi i librezave të punës.

Në periudhën Janar-Dhjetor 2017 janë përditësuar 249 libреза pune të cilat edhe janë nënshkruar nga punonjësi i autorizuar dhe janë vulosur pranë zyrës së protokollit.

Është bërë e mundur rregjistrimi i tyre në regjistrat themeltarë. Është bërë e mundur hedhja në sistemin on line të DAP për 211 vende vakante.

Në tetor 2017, Drejtori i Përgjithshëm miratoi me urdhrin nr. 65, datë 04.10.2017, Rregulloren “Për përcaktimin e procedurave të rekrutimit, emërimit, vlerësimit, marrjen e masave disiplinore për punonjësit e strukturave të hetimit tatimor”, si një akt që garanton përcaktimin e kriterëve të

qarta, të përshtatshme, të bera publike dhe përcakton mënyrën e rekrutimit të punonjësve që do të punojnë në strukturat e hetimit tatimor.

Drejtoria e Burimeve Njerëzore, në zbatim të dispozitave ligjore, organizoi procedurën e parë të konkurrimit për pranim në strukturat e hetimit tatimor, në të cilën morën pjesë 84 aplikantë dhe rezultuan fitues 8 prej tyre.

Trajnimi dhe Vlerësimi i Punonjësve

Në zbatim të Programit Vjetor të Trajnimit të miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve, me vendimin Nr.1, datë 04.01.2017, dhe nisur nga ndryshimet në strukturën organizative të Administratës Tatimore Qendrore, mbi të cilën është miratuar edhe Rregullorja e Brendshme “Për funksionimin e Administratës Tatimore Qendrore në bashkëpunim me QTATD, është miratuar kalendari vjetor i trajnimit sipas temave konkrete nga 03.05.2017 dhe ka përfunduar në 20 Dhjetor 2017, gjithsej janë trajnuar 600-punonjës të administratës tatimore.

Në këtë periudhë janë trajnuar nëpunësit civil të nivelit ekzekutiv/mesëm drejtues në Drejtoritë Rajonale Tatimore (specialist, inspektor tatimor, përgjegjës sektori/drejtor të drejtorisë sipas nevojave për temat konkrete të ardhura nga propozime të DRT dhe Drejtorive në DPT, me tema sipas funksioneve për strukturën e kontrollit, shërbimit, mbledhjes me forcë, shërbimeve mbështetëse dhe hetimit tatimor) .

- a) Në muajin Shkurt-Mars 2017, për shkak të ndryshimit në strukturë, sipas Urdhrit Nr. 126, datë 02.08.2016 , me shkresën Nr. 3016 datë 08.02.2017 dhe 3264 datë 10.02.2017, drejtuar QTATD (në bashkëpunim) u planifikua dhe është zhvilluar trajnimi me temë Ligji “Për procedurat tatimore”, i ndryshuar, Rregullorja e Hetimit dhe Manuali i Hetimit Tatimor për 130 punonjës.
- b) Në bashkëpunim me QTATD, u zhvillua trajnimi dhe testimi në muajin Shtator dhe Nëntor me 41-nëpunës në periudhë prove, të cilët kaluan testimin dhe kanë përfituar certifikatën pranë ASPA, si një ndër kushtet për kryerjen e trajnimit të detyrueshëm për përfitimin e certifikatës me qëllim konfirmimin si nëpunës civil, bazuar edhe në vlerësimin e rezultatetve në punë për periudhën e provës.

XVI. BUXHETI DHE FINANCA

Në bazë të miratimit të tavane buxhetore nga Minsitria e Financës dhe Ekonomisë, Drejtoria e Buxhetit dhe Financës ka zbatuar me rigorozitet dhe me përpikmëri tërësinë e shpenzimeve korente dhe kapitale për Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve duke përmbledhur edhe Drejtoritë Rajonale.

Në termat sasiorë të realizimit të shpenzimeve gjejnë përputhje me realizimin e objektivave institucionale të DPT-së.


Shpenzimet buxhetore janë realizuar në total në masën 94 % ndaj planit të rishikuar.

1. Shpenzimet për pagat janë realizuar në masën 96 %.
2. Shpenzimet për mallra e shërbime janë realizuar në masën 97%.
3. Shpenzimet për tranferta në buxhetet familjare në masën 98%.
4. Shpenzimet për investime në masën 25%.

Tabela 20. Buxhetimi dhe shpenzimet

	Plan	Fakt	Realizimi	% mbi
Shpenzime për Paga	1,399,059	1,339,221	96%	58.1%
Shpenzime Sigurime Shoqërore dhe Shëndetsore	242,763	222,757	92%	9.7%
Shpenzime mallra shërbime	748,500	723,528	97%	31.4%
Transferta korente me jashtë	1,260	1,214	96%	0.1%
Transferta per buxhetet familjare dhe individët	1,933	1,888	98%	0.1%
Shpenzime për investime te patrupëzuara	4,746	4,746	100%	0.2%
Shpenzime për investime te trupëzuara	64,000	12,416	19%	0.5%
Totali	2,462,261	2,305,770	94%	100.0%

Grafik 6. Buxhetimi dhe shpenzimet



Tabela

Tabela 1. Totali DPT 12-mujori 2017.....	11
Tabela 2. Të ardhurat e realizuara për vitin 2017 sipas DRT-ve (000/lekë).....	13
Tabela 3. Të ardhura nga Tatimi mbi Vlerën e Shtuar (000/lekë)	14
Tabela 4. Te ardhura nga Tatimi mbi Fitimin 12 Mujori (000/lekë)	14
Tabela 5. Te ardhura nga Tatimi mbi te Ardhurat Personale (000/lekë).....	15
Tabela 6. Krahaskimi TAP sipas zerave (000 leke).....	15
Tabela 7. Te ardhura nga Taksat Kombetare dhe Tarifa (000 leke)	17
Tabela 8. Taksat Kombetare dhe Tarifat sipas llojeve (përfshirë Tarifa Buxhetore).....	18
Tabela 9. Te ardhura nga Taksa e Qarkullimit dhe Karburantit (000 leke).....	19
Tabela 10. Te ardhurat nga sigurimet shoqerore & shendetesore	19
Tabela 16. Realizimi i planit të numrit të kontrolleve për periudhën vitin 2017, sipas DRT,	29
Tabela 17. Sektorët me Risk për të gjitha Drejtoritë Rajonale	33
Tabela 18. Piket e riskut sipas sektoreve	35
Tabela 19: Pasqyra permbledhese e faljeve automatike dhe manuale	41
Tabela 20. Situata e rimbursimit për kërkesat e mbartura nga viti 2016 deri në fund të vitit 2017	50
Tabela 21. Pesha specifike e DRT në dhënien e rimbursimit për kërkesat e mbartura nga viti 2016 të rimbursuara nëpërmjet sistemit të thesarit brenda datës 31.12.2017	51
Tabela 22. Situata e kërkesave të paraqitura gjatë vitit 2017 sipas periudhës së depozitimit të kërkesës ..	52
Tabela 23. Situata e rimbursimit për kërkesat e vitit 2017 deri në fund të vitit 2017	52
Tabela 24. Pesha specifike që zë çdo DRT në dhënien e rimbursimit Cash për kërkesa të vitit 2017 të paguara nëpërmjet sistemit të thesarit brenda datës 31.12.2017	54
Tabela 25. Numër referimesh në prokurori sipas Neneve dhe Prokurorive përkatëse.....	Error! Bookmark not defined.
Tabela 26. Numër referimesh në Prokurori '17 vs.'16	Error! Bookmark not defined.
Tabela 27. Statistike e veprave penale Janar – Dhjetor 2017.....	Error! Bookmark not defined.
Tabela 28. Referime në Prokurori sipas Neneve dhe Prokurorive nga Sektori I Hetimit në DPT.....	Error! Bookmark not defined.
Tabela 29. Referimet në bazë të Prokurorive:.....	Error! Bookmark not defined.
Tabela 30. Penalitetet e vendosura nga Task Force	Error! Bookmark not defined.
Tabela 31. Numri i denoncimeve	Error! Bookmark not defined.
Tabela 32. Rezultatet e Drejtorise se Hetimit Tatimor Rajoni Qendror.....	Error! Bookmark not defined.
Tabela 33. Rezultatet sipas qarqeve nga Drejtoria e Hetimit Tatimor Rajoni Qendror	Error! Bookmark not defined.

Tabela 34. Subjekte te bllokuara nga Drejtoria e Hetimit Tatimor Rajoni Qendror..**Error! Bookmark not defined.**

Tabela 35. Kontrollat e baxhove nga Drejtoria e Hetimit Tatimor Rajoni Qendror..**Error! Bookmark not defined.**

Tabela 36. Sektori i Analizës në Drejtorinë e Hetimit Tatimor Rajoni Qendror për vitin 2017**Error! Bookmark not defined.**

Tabela 37. Sektori i Analizës në Drejtorinë e Hetimit Tatimor Rajoni Jugor për vitin 2017**Error! Bookmark not defined.**

Tabela 38. Rezultat e Drejtorisë së Hetimit Tatimor Rajoni Jugor **Error! Bookmark not defined.**

Tabela 39. Rezultatet e Drejtorisë së Hetimit Tatimor Rajoni Verior **Error! Bookmark not defined.**

Tabela 40. Vlerësimet e Rezultateve në Punë për 6-mujorin e parë të vitit 2017**Error! Bookmark not defined.**

Tabela 41. Vlerësimet e nëpunësve civil në Administratën Tatimore 6 –mujori II 2017..**Error! Bookmark not defined.**

Tabela 42. Vlerësimi vjetor i rezultateve në punë për punonjësit me Kod Pune në ..**Error! Bookmark not defined.**

Tabela 43. Buxheti dhe shpenzimet.....69

Grafikë

Grafik 1. Struktura e te ardhurave.....	11
Grafik 2. Struktura e borxhit tatimore.....	39
Grafik 3. Borxhi sipas llojit të Tatimit 2016 vs 2017	39
Grafik 4. Mosha e borxhit.....	40
Grafik 5. Borxhi sipas statusit të tatimpaguesit	40
Grafik 6. Numër kontrollesh të kryera nga Sektorët e Zbatimit	Error! Bookmark not defined.
Grafik 7. Penalitete në numër nga Sektoret e Zbatimit.....	Error! Bookmark not defined.
Grafik 8. % e subjekteve nga Sektorët e Zbatimit	Error! Bookmark not defined.
Grafik 9. Vlera e shkeljeve sipas rajoneve.....	Error! Bookmark not defined.
Grafik 10. Subjekte pa licensë	Error! Bookmark not defined.
Grafik 11. Subjekte penalizuar për moslëshim kuponi (herë e dytë)	Error! Bookmark not defined.
Grafik 12. Gjoha për punonjës të padeklaruar në numër	Error! Bookmark not defined.
Grafik 13. Gjoha për punonjës të padeklaruar në vlerë.	Error! Bookmark not defined.
Grafik 14. Subjekte të penalizuara për Moslëshim kuponi në numër	Error! Bookmark not defined.
Grafik 15. Subjekte të penalizuara për Moslëshim kuponi në vlerë.	Error! Bookmark not defined.
Grafik 16. Subjekte me shkelje të tjera në numër.	Error! Bookmark not defined.
Grafik 17. Subjekte me shkelje të tjera në vlerë	Error! Bookmark not defined.
Grafik 18. Numër referimesh sipas prokurorive	Error! Bookmark not defined.
Grafik 19. Referime në Prokurori, '17 vs. '16	Error! Bookmark not defined.
Grafik 20. Ecuria e nivelit të xhiros për vitin 2017 krahasuar me vitin 2016.....	Error! Bookmark not defined.
Grafik 21. Ecuria e nivelit të kuponit për vitin 2017 krahasuar me vitin 2016.....	Error! Bookmark not defined.
Grafik 22. Xhiro 2017 vs. 2016	Error! Bookmark not defined.
Grafik 23. Rritja në % e nivelit të xhiros dhe kuponave '17 vs. '16.....	Error! Bookmark not defined.
Grafik 24. Rritja e nivelit të xhiros sipas DRT-ve dhe sipas përgjegjësisë tatimore.	Error! Bookmark not defined.
Grafik 25. Rritja e nivelit të kuponave sipas DRT-ve dhe sipas përgjegjësisë tatimore... ..	Error! Bookmark not defined.
Grafik 26. Rritja në vlerë (lekë) e xhiros krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë	Error! Bookmark not defined.
Grafik 27. Rritja në numër kuponash krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.	Error! Bookmark not defined.
Grafik 28. Buxhetimi dhe shpenzimet	70



